



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 9.3. 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
9.03. 2012. GODINE**

**MARS– MART
2012**

E premte, më 9.3.2012, ora 11:00

Drejtton seancën kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Prezentë në sallë janë 80 deputetë dhe kështu mund t'ia fillojmë punës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës

1. Debat parlamentar për Ditën Ndërkombëtare të Gruas

Sot jemi më 9 mars, por edhe ia vlen për t'ua nderuar 8 Marsin.

Grupi i Grave Deputete, i përkrahur nga 44 deputete, nënshkruese, ka parashtruar në Kuvend, kërkesë për seancë të veçantë pune, me rastin e 8 Marsit- Ditës Ndërkombëtare të Gruas.

Ftoj deputeten Teuta Sahatqija, në cilësinë e kryetares së Grupit të Grave Deputete, që të paraqesë arsyetimin e kërkesës për debat.

TEUTA SAHATQIJA: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar, Qeveri,

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Grupi i Grave Deputete ka kërkuar një seancë të veçantë, jo seancë festive, jo seancë solemne, por seancë ku do të debatohet për pozitën e gruas në shoqërinë kosovare dhe nga debati do të presim që të dalim me rekomandime konkrete për përmirësimin e pozitës së saj.

Në këtë iniciativë kemi mbledhur 44 nënshkrime, 28 nënshkrues janë burra dhe 16 nënshkruese janë gra, nga të gjitha partitë dhe të gjitha nacionalitetet në Kosovë.

Numri i nënshkruesve me siguri do të ishte edhe më i madh, por me plotësimin e numrit të mjaftueshëm, ne e ndërprejmë kërkimin e mëtejshëm të nënshkrimeve. Ky numër i madh i nënshkrimeve jep përshtypjen se diskutimi pritet të jetë gjithëpërfshirës, si në aspektin gjinor, ashtu edhe në atë të temave të trajtuara, por edhe të aprovimit të rekomandimeve që do të dalin nga kjo seancë.

Thirrja e seancës për këtë temë nuk është iniciativë e vetmuar në Kosovë, as në rajon. Gratë për këtë rast kanë organizuar në shumë parlamente debate për këtë temë.

Kërkesa jonë për debat do të fokusohet në qasjen e gruas në drejtësi, në fuqizimin ekonomik të saj, por edhe në tema tjera të cilat paraqesin një pasqyrë reale të pozitës së gruas në shoqërinë kosovare.

Ne jemi të vetëdijshme që ky është problem shumëdimensional dhe zgjidhja nuk është as e lehtë as e menjëhershme, por e dimë se zgjidhja duhet të kërkohet në aspektin institucional përmes hartimit dhe implementimit të ligjeve, në aspektin edukativ, përmes përmirësimit të kurikulumeve, në aspektin shoqëror përmes heqjes së stereotipave medial e tjera, por definitivisht së bashku gratë dhe burrat.

Rasti më i rëndë është kur gruaja ka nevojë për qasje në drejtësi. Zakonisht është ajo grua e cila nuk ka zë, gruaja e cila ballafaqohet me mungesë të fuqisë ekonomike e cila do t'i siguronte dinjitetin dhe pavarësinë në zgjedhjen e saj, gruaja e cila ka mungesë të shkollimit të mjaftueshëm që do t'i siguronte pavarësinë e saj, gruaja e cila është e detyruar të gjejë shpëtim të përkohshëm në strehimore, të cilat janë të mbushura me gra e jo me burra.

Gruaja pa zë është viktimë e mentalitetit të mbrapambetur primitiv dhe patriarkal, mentalitetit fatkeqësisht ende prezent në mesin tonë, mentalitet i cili sot e kësaj dite merr jetë të grave. Le ta kujtojmë Dianën, e cila u vra në mes të ditës, në mes të qytetit. T'i kujtojmë edhe shumë Diana tjera të cilat, nëse nuk e kanë humbur jetën, atëherë kanë humbur dinjitetin, kanë humbur shëndetin, kanë humbur familjen dhe në fund e kanë humbur shpresën.

Ky mentalitet i mbrapshtë pengon që të flitet për varrën e madhe të luftës, për gratë e dhunuara të cilat janë viktimat më të dhimbshme të luftës.

Çdo burrë me krenari tregon për kohën apo për plagët që i ka marrë gjatë luftës, por nuk duron që të flasim këto gra për varrat, për plagët në trup edhe më tepër për plagët në shpirt, të cilat kurrë nuk do të shërohen.

Për këto gra pa zë duhet të flasim ne, gratë dhe burrat dhe pas aq shumë vitesh të bëjmë zgjidhje, sepse atyre u kemi borxh, ndonëse ka zhvillime pozitive.

Sot ende mentaliteti pengon vajzën ta marrë hisen, në pronën e prindërve, të hyjë në martesë pa pronë, pa mundësi të marrjes së kredisë për nisjen e çfarëdo biznesi, pa mundësi të hapjes së biznesit për më shumë mundësi që të shndërrohet në një grua pa zë, e cila nuk ka qasje në drejtësi dhe një banore e ardhme e shtëpive të sigurta apo në ndonjë kronikë të zezë në faqet e fundit të gazetave.

Në librat tanë shkollor flitet për Kështjellën e Rozafatit, flitet për Urën e Shenjtë, ku si virtyt i burrit është vendos të sakrifikojë gruan e tij, që është një çështje madhore, për një çështje madhore. Ndërsa, virtyti i gruas është të vetësakrifikohet për një të mirë madhore dhe deri në momentin e fundit të jetës së saj të mendojë për ta ushqyer të birin dhe ta përkundë që ai të bëhet burrë i fortë, i cili do ta vazhdojë ta sakrifikojë gruan e tij të ardhshme për një të mirë madhore.

Si prioritet i tretë i objektivit të zhvillimit të milienumit në botë që është pas zhdukjes së varfërisë dhe edukimit universal, pason barazia gjinore. Dhe, kjo tregon që në botë barazia gjinore konsiderohet një prej prioriteteve më të rëndësishme për shoqërinë.

Ne presim nga burrat e Kuvendit, presim nga nënshkruesit, si përfaqësues të popullit dhe persona të respektuar në Kuvend, që përmes diskutimeve të tyre dashamirëse dhe konstruktive, të japin mesazhin, jo vetëm sa i përket emancipimit të gruas, por emancipimit të burrit, pa të cilin ndryshimet do të ishin të vështira.

Gjatë punës tonë ne kemi hartuar disa rekomandime. Unë do t'i lexoj ato rekomandime dhe në fund pas dakordimit do t'i paraqesim në Kuvend.

Rekomandimet dhe konkluzionet janë:

Që të gjitha ligjet që draftohen dhe gjatë procesit të shqyrtimit, të trajtohen kah perspektiva gjinore. Forcimi dhe rritja e efikasitetit të punës së mekanizmave ligjor, gjykata, prokuroria, policia e të tjera, për t'i implementuar të drejtat e gruas.

Të trajtohen me ligj rastet e grave të dhunuara gjatë luftës, të cilat përveç dhunimit, ato ua anatemuuan dhe u fajësuan padrejtësisht, madje edhe nga më të afërmit. Për këto raste kërkojmë të zbatohet drejtësia dhe kërkojmë që në dialog me Serbinë, të jetë edhe kjo një pikë.

Të përshpejtohen proceset gjyqësore duke thjeshtuar procedurat për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, sidomos dhunës ndaj gruas. Të punohet në vetëdijesimin e grave për t'i njohur të drejtat e tyre, sidomos të drejtat për punë, për trashëgimi, përfaqësim, të drejtat civile e të tjera.

Mungesa e drejtësisë të luftohet duke kërkuar zbatimin e Ligjit për barazi gjinore, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjit kundër diskriminimit, konventat e ndryshme ndërkombëtare.

Që të bëhet trajnimi dhe përgatitja e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit adekuat policor për trajtimin profesional specifik të rasteve të dhunës në familje dhe të drejtave të gruas. Të bëhet më tepër për zbatimin e Rezolutës 1325 dhe përfshirjen e gruas në politikëbërje. Të punohet më tepër për sigurimin e strehimoreve të mjaftueshme dhe në përmirësimin e kushteve në to dhe të zbatohet ligji që ushtruesi i dhunës të largohet nga shtëpia e jo viktima.

Që të bëhet përkrahja e afarizmit të grave përmes politikave që fuqizojnë ekonomikisht gratë dhe favorizojnë iniciativat e grave në biznes. Të hartohet strategjia kombëtare për gratë në biznes.

Në universitete të zhvillohen kurikulumet në favor të politikave gjinore, në veçanti politika që përgatisin gratë për veprimtari ekonomike.

Të shikohet mundësia e krijimit të Fondit për zhvillimin e bizneseve të grave. Të themelohet një Komision që do të vlerësonte dhe përcillte gjendjen dhe veprimtarinë e grave në biznes. Të rritet partneriteti publiko- privat, me qëllim që të fuqizohet roli i gruas në ekonomi. Të rritet prezenca e grave në bordet e ndërmarrjeve publike, gjë të cilën Suedia ka rezultate jashtëzakonisht të mira në këtë aspekt. Të nxitet absorbimi i grave nga organizatat vendore, të përkrahen gratë kryefamiljare për të filluar apo zhvilluar afarizëm. Të bëhet platforma për menaxhimin e rritjes së fëmijëve në mënyrë që të mos pengohen gratë për angazhime profesionale.

Këto janë rekomandimet të cilat ne si Grup i Grave Deputete i kemi arrit. Besojmë që prej diskutimeve do të ketë edhe rekomandime tjera, të cilat në fund do t'i dakordojmë dhe i qesim në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Prej Qeverisë më duket nuk ka të interesuar për të folur.

Nëse e do fjalën kryetarja e Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Sot është për t'u përshëndetur që ky Kuvend po hap një kapitull të ri në organizimin e kësaj seance të veçantë kushtuar të drejtave të grave në Republikën e Kosovës.

Falënderim i veçantë për të gjithë ata që punuan që ky Kuvend të jetë vendi ku bëhet bilanci i gjithë angazhimit të bërë në miratimin e politikave dhe ligjeve jo diskriminuese për gratë në Kosovë.

Të drejtat e grave kanë qenë gjithmonë një sfidë e vjetër sa edhe vetë njerëzimi. Vërtet, gruaja gjatë historisë ka pasur rol të rëndësishëm jo vetëm në krijimin dhe ngritjen e familjes, por edhe në zhvillimin e shoqërisë në tërësi. Bota moderne ka ndërtuar politika dhe dispozita ligjore me të cilat e barazon gruan me burrin, por jo gjithnjë këto ligje janë zbatuar në mënyrë të njëjtë në të gjitha vendet.

Sot, gruaja me të drejtë themi se është aktive në të gjitha fushat e jetës: si në politikë, biznes, shkollim, trashëgimi dhe të në gjitha sfera tjera jetësore që gëzon edhe bota mashkullore, por në praktikë, me vërejtje se realizimi i të drejtave të saja has në shumë pengesa.

Po vërtet si është Kosova sot, sa legjislacioni ynë krijon mundësi të barabarta, si të burrit ashtu edhe të gruas, cilat janë politikat e shtetit në realizimin e të drejtave të gruas? Vendi ynë ka miratuar legjislacion modern, bazuar në standardet më të mira evropiane dhe ndërkombëtare, por cila është shkalla e zbatimit në praktikë, është çështje që duhet të trajtohet jo vetëm këtu dhe se gjithë interesimi ynë duhet të fokusohet në realizimin praktikë të drejtave të gruas.

Është koha e fundit që gruaja të vetëdijesohet për të drejtat e veta kushtetuese dhe ligjore që i takojnë dhe me mënyrën se si t'i realizojë ato, si në të drejtën e gruas për personalitet ligjor, të drejtën e gruas për respektimin e jetës së tyre dhe integritetit të tyre fizik dhe mental, të drejtat e tyre për mbrojtjet nga skllavëria, puna e dhunshme dhe e detyruar, trafikimi, e drejta për barazi në martesë, gëzimi i të drejtës së barabartë për kapacitet ligjor në çështjet civile, e drejta e grave për pjesëmarrje të barabartë në jetën publike, përfshirë edhe zgjedhjet dhe të drejtat tjera universale të njeriut.

Akoma kemi raste dhe dukuri në shoqërinë tonë të mosrespektimit dhe shkeljes së të drejtës dhe personalitetit të femrës në Kosovë. Prandaj, është momenti i fundit që shoqëria jonë të sensibilizohet dhe vetëdijesohet për respektimin dhe trajtimin e merituar të femrës në shoqëri. Jo vetëm Kuvendi, por edhe ekzekutivi, gjyqësori, familja, në rend të parë, shoqëria civile, mediat dhe instancat tjera, duhet angazhuar për një jetë të barabartë të burrit dhe të gruas në të gjitha sferat.

Përkundër që ligjet ndërkombëtare trajtojnë në bazë të barabartë të drejtat e gruas dhe burrit, megjithatë në shumë vende të botës, gëzimi i këtyre të drejtave është vetëm një iluzion dhe kjo u jap përgjegjësi të veçantë të gjithë profesionistëve ligjor për të drejtat e njeriut.

Ne duhet të synojmë dhe të bëjmë përpjekje që në të ardhmen në të gjitha nivelet të sigurohet që gratë janë me të vërtetë në gjendje të ushtrojnë t'i drejtat e tyre, pa frikë se do të rrahën, vriten apo në rastet më të mira të jenë të papranueshme në shoqëri.

Kolegë deputetë,

Në fund do të doja t'u uroja të gjithë grave të botës e në veçanti të Kosovës, 8 Marsin si dhe çështja e gruas të mos jetë temë trajtimi e vetëm një dite në vit, por që kjo çështje të jetë e përhershme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Blerta Deliu - Kodra.

BLERTA DELIU- KODRA: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

E nderuar ministre Çitaku,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolege deputete dhe të nderuar kolegë deputetë,

Për të aderuar në Bashkim Evropian Kosova, duhet të përmbushë edhe kriterin gjinor, i cili në plan të veprimit për partneritet evropian, është radhitur në kriteret politike.

Raporti i sivjetmë i Progresit thotë se Kosova ka shënuar progres në këtë drejtim. Zgjedhja e zonjës Atifete Jahjaga për presidente të Kosovës, emërimi i dy grave si zëvendëskryemistre, duke përfshirë këtu edhe negociatoren në dialogun Beograd – Prishtinë, si dhe ministren e Integritimit Evropian, përbëjnë një hap jashtëzakonisht të rëndësishëm të cilin e ka vlerësuar, madje edhe Bashkimi Evropian.

Po ashtu edhe legjislacioni në Kosovë afron një bazë të mirë për inkurajimin dhe mbështetjen e pjesëmarrjes së gruas në procesin e punës dhe në pozita vendimmarrëse.

Me krijimin e mekanizmave institucional edhe masave afirmative për barazi gjinore në gjitha nivelet e qeverisjes, është hapur një derë e re e mundësive për përfshirjen e grave në procesin e punës dhe në vendimmarrje.

Pavarësia ekonomike mbetet akoma si çelësi kryesor për realizimin e së drejtës së barabartë për pozita në vendimmarrje.

Ndërkaq, Kosova në përfaqësimin gjinor në nivel vendimmarrje mbetet e 17-ta në botë, kurse në rajon Kosova renditet ndër vendet e para në përfaqësimin institucional të gruas.

Ndërsa, legjislacioni promovon fuqishëm edhe parimin e barazisë gjinore, Kushtetuta, si akti më i rëndësishëm juridik i një shteti, respekton dhe promovon parimin e barazisë gjinore, të cilat janë të pranuar edhe ndërkombëtarisht. Për më tepër Kushtetuta ndalon çdo formë të diskriminimit edhe atë në baza gjinore. Madje, Ligji kundër diskriminimit parasheh edhe sanksione për persona të cilët shkelin dispozitat e këtij ligji.

Ligji për barazi gjinore përcakton edhe një sërë masash ligjore për arritjen e barazisë së plotë të femrave dhe të meshkujve në shoqëri. Po ashtu Ligji kundër diskriminimit promovon parimet e barazisë gjinore dhe kundër diskriminimit në baza gjinore.

Me aprovimin e Ligjit të punës, gratë kanë fituar të drejtën e pushimit të lehonisë, nga 10 javë sa ishte në legjislacionin e kaluar, në 6 muaj, me mundësi vazhdimi pa pagesë, deri në 12 muaj, megjithëse zbatimi i kësaj norme mund të jetë edhe sfidë për të punësuarat në sektorin privat. Ajo që mbetet po ashtu sfiduese është se ligji nuk afron pagë të plotë për pushimin e lehonisë, pasi që gjatë kësaj kohe e punësuarat paguhet vetëm 70% të pagës së saj, për 6 muaj të parë, 50% për 3 muajt në vijim, kurse pjesa tjetër prej 3 muajsh mund të merret vetëm pa pagesë.

Nenet e këtij ligji afrojnë lehtësira për femrat e punësuarat në rrethanat speciale. Për shembull, punëdhënësi nuk mund të sistemojë në një vend pune jashtë vendbanimit, pa pëlqimin e tyre. Po ashtu ligji ndalon punën e natës për gratë shtatzëna.

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,
Institucionet kanë bërë përpjekje të pareshtura në arritjen e barazisë gjinore e në veçanti në avancimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe në jetën publike.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah debatin e sotëm dhe inkurajon institucionet në angazhimin e tyre në fushën e barazisë gjinore, duke vlerësuar kështu se në këtë mënyrë ne po përmbushim standardet tona si një shtet demokratik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari i Grupit, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë, kolege,

Fillimisht, më lejoni në emër të Grupit, sigurisht, pastaj edhe secili e ka të drejtën që t'ua uroj Ditën Ndërkombëtare të Gruas dhe të përshëndes njëkohësisht në emër të Grupit këtë iniciativë për një debat. Njëkohësisht edhe përshëndes gjithë punën që e bën edhe Grupi i Grave Deputete, në punën e saj, jo vetëm në Parlament, por edhe në përgjithësi në aktivitetet edhe jashtë Parlamentit, në aspektin e përkrahjes, të fuqizimit të vetë gruas.

Pa dyshim që të drejtat e gruas janë fundamentale për zhvillimin e një shoqërie, duke e ditur faktin që gruaja është shtyllë e familjes dhe e vetë shtetit.

Është shumë e qartë që gruaja nuk duhet shikuar si numër, por si vlerë dhe arsimimi i gruas, do të thotë, njëkohësisht edhe arsimim dhe zhvillim i shoqërisë. Është shumë e qartë që nuk shoqëri të arsimuar dhe të zhvilluar po që se pjesa, jo vetëm nga fakti që është gjysma e popullatës, flasim në Kosovë, është e gjinisë femërore, por edhe nga arsyeja e thjeshtë se këto janë vlera si gjini dhe si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre, pa dyshim nuk janë diçka që u dhurohen, por janë të drejta që i fitojnë, me të lindur. Andaj edhe ato akte dhe ligje që gjer më tani i kemi në Kosovë, përkundër avancimeve të caktuara, nuk duhet t'i marrin që janë aq rezultateve, sepse fatkeqësisht në shumë pjesë të Ligjit, po e zëmë për barazinë gjinore, nuk zbatohet ato që i parasheh vetë ligji. Merrni paragrafin, shembull 3.2 të këtij ligji i cili thotë ose flet për përfaqësimin e gruas deri në 40% dhe ne kemi obligim që të bëjmë përpjekje që në të gjitha institucionet tona t'u krijojmë hapësirë dhe mundësi që kjo pjesë e ligjit dhe pjesë tjera, nene të këtij ligji, të vijin në zbatim si kundër që mund të flasim për mangësi ose moszbatim edhe të disa neneve dhe pikave edhe të ligjeve tjera siç është edhe Ligji për punën.

Është e padiskutueshme që sot në Kosovë, me gjithë avancimet, ka edhe shumë hapësirë që gruaja të fuqizohet dhe roli i saj të jetë edhe më i madh në shoqëri, duke filluar nga gjitha segmentet e shoqërisë dhe të gjitha institucionet. Është e padiskutueshme që ne kemi mungesë të madhe të përfaqësimit gjinor në institucione të ndryshme, po përmenden, por po e them edhe këtë që nga bordet e ndryshme të ndërmarrjeve, pse jo edhe në udhëheqje të ndryshme, në komunat tona të Kosovës, nuk mjafton ne të kënaqemi me të udhëhequrit e disa ministrive ose 2 – 3 ministrive e të themi se është mjaftë. Është shumë e qartë edhe për opinionin edhe për qytetarët që gratë në menaxhim kanë treguar që janë shumë më të kujdesshme dhe janë shumë të afta dhe thënë sinqerisht edhe janë më pa korruptuara. Nuk është ajo se nuk po u krijohet mundësia që këto të jenë më shumë të përfaqësuara pastaj do të ishin më të korruptuara. Mjafton edhe në dy vende nëse janë të përfaqësuara, që tregojnë se dinë me qenë të korruptuara, por kjo nuk po ndodhë fatbardhësisht dhe tregojnë që në raport me gjininë tjetër, po e them me përgjegjësi të plotë, janë shumë më të kujdesshme dhe sot keni shumë pak raste kur gruaja ose femra, ose punëtorja në cilindo institucion që punon hetohet për dukuri të tilla kancerogjene që janë në Kosovë, siç është korrupsioni.

Andaj, ne duhet duke i parë këto vlera, të krijojmë sa më tepër hapësirë që vërtet të vjen shprehje ky menaxhim që për mendimin tim është shumë i suksesshëm dhe është dëshmuar në shumë vende që këto gra, veçmas gruaja në Kosovë dinë dhe mund të udhëheqin pse jo siç po e udhëheqin edhe shtetin, po të udhëheqin edhe me institucionet e tjera.

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim që ne edhe me rastin e zgjedhjeve kemi dëshmuar, gjegjësisht, qytetarët tanë kanë dëshmuar se shumë deputete sot i keni në Parlament, jo për shkak të kuotës, por për shkak të votës, për shkak të asaj se qytetarët u kanë besuar dhe sot i keni ulur këtu. Shumë raste të rralla flas edhe për deputetet e Lidhjes Demokratike të Kosovës, por e besoj edhe te grupet tjera, nuk janë ulur vetëm për shkak të kuotës gjinore, që është obligim dhe kushtëzim, në një mënyrë, por për arsyen e thjeshtë se e kanë marrë besimin e qytetarëve dhe kjo është dëshmia më e mirë që këto edhe mund edhe të udhëheqin edhe të kenë besim të qytetarëve.

Prandaj, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i përkrah edhe ato rekomandime që janë propozuar, sepse nuk janë rekomandime partiake, nuk janë në këtë rast mund të them as rekomandime gjinore, por janë rekomandime për fuqizimin e pjesës vitale, të rëndësishme të shoqërisë tonë, në këtë rast të gruas. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Dje, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në qendër të Prishtinës u mbajt një protestë për një çështje që deri tani në Kosovë, është konsideruar tabu.

Po kështu lëvizja “Vetëvendosje” organizoi një tribunë, e cila synonte të dekonstruktonte këtë tabu dhe të ngrinte zërin për drejtësi, ne emër të viktimave të cilat në këtë shoqëri nuk kanë zë.

Kanë kaluar 13 vjet dhe ato ende nuk kanë zë, ato heshtin, sepse shoqëria i dënon, ato vuajnë, sepse shteti nuk i ndihmon, ato fshehin vuajtjen dhe trishtimin, sepse drejtësia nuk bëri asgjë për to.

E në rast se edhe ne, përfaqësuesit e tyre në institucione heshtim, ato do të heshtin përgjithmonë, krimi ndaj tyre do të harrohet, sepse ai nuk u njoh kurrë.

E kam fjalën për ato mijëra gra të cilat janë viktima të shumëfishta, të brutalitetit të ushtrisë e policisë serbe, të injorimit të drejtësisë ndërkombëtare, të mentalitetit përjashtues të vet shoqërisë dhe të harresës institucionale.

Dhunimi u përdor si hakmarrje me destinacion shkatërrimin e qelizës së shoqërisë, familjen dhe traumatizmin e disa brezave.

Dhunimi i grave dhe vajzave gjatë luftës u përdor si një armë lufte, si një strategji për të nënshtruar dhe terrorizuar të gjithë popullatën, poshtërimi u përdor për të bërë spastrim etnik.

Mijëra viktima të këtij krimi të shëmtuar më pas u vranë, ndërsa mijëra të tjera që mbetën gjallë, vuajnë të heshtura dhimbjen. Shumë prej tyre pas luftës humbën bashkëshortët, fëmijët, u përjashtuan nga shoqëria dhe sot vuajnë traumat shpirtërore .

Pas përfundimit të luftës, gazetarët ndërkombëtar raportuan për këtë fenomen, ndërsa Human Rights Watch, pat filluar investigimin për këtë krim. Kërkimet gjetën që më 1999, dhunimi dhe forma të tjera të dhunës seksuale, ishte përdorur në Kosovë, si një armë lufte dhe si një instrument për të bërë spastrim etnik, sistematik. Po sipas raportit të tyre, dhunimi nuk ishte një akt i rrallë e i izoluar nga forcat jugosllave dhe individë serbë, por shpesh ishte përdorur si një instrument për të terrorizuar popullatën civile, për t'iu marrë paratë familjeve dhe detyruar familjet t'i braktisnin shtëpitë e tyre. Kërkime të organizatave të tjera për të drejtat e njeriut kanë dalë me të njëjtat rezultate.

Ndërsa, në Konferencën e Katërt Botërore të Grave, dhunimi në luftë është deklaruar si krim lufte dhe në disa rrethana mund të konsiderohet edhe gjenocid. Po kështu, Kombet e Bashkuara në atë kohë i bënë thirrje drejtësisë ndërkombëtare të adaptojnë legjislacionin e nevojshëm për ta klasifikuar këtë si krim lufte dhe gjenocid, në fakt legjislacioni është adaptuar.

Mirëpo, është gjithashtu fakt se drejtësia ndërkombëtare në Hagë, edhe pse ka ngritur akuza për dhunimet masive, deri tani askush nuk është dënuar për një krim të tillë. Unë nuk mund të besoj se ata e konsiderojnë këtë krim më të parëndësishëm se llojet e krimeve të tjera, ashtu sikurse nuk mund të besoj se kjo ka ardhur si pasojë e mungesës së dëshmive.

Janë me dhjetëra gra aktiviste të shoqatave të ndryshme në Kosovë, të cilat gjatë luftës, me guxim e kurajo, shpesh duke rrezikuar edhe jetën e tyre, kanë mbledhur me qindra dëshmi të tilla.

Edhe vetë jam takuar me disa prej tyre. Ata kanë vendosur ta marrin të vërtetën e tyre në varr, jo sepse ky është vullneti i tyre, por sepse nuk e kanë parë dritën e drejtësisë deri tani, as të asaj ndërkombëtare dhe as të asaj vendore.

Por ajo që i rëndon më së shumti është se nuk e kanë gjetur as mbështetjen e shtetit të Kosovës, për krijimin e të cilit sakrifikuan. Sot ato gra janë të papuna, në depresion, shpesh paciente të sëmundjeve të shumëfishta, të lëna në harresë.

Është për të ardhur keq që ata që e kanë pasur më të lehtë në luftë, burrat, janë të parët që dalin e krekosen për luftën dhe vjelin frytet e saj. Sakrifika e grave është shumë më e madhe, ato nuk kanë mundur thjesht të marrin pushkën e të dalin në mal. Ato është dashur t'i ruajnë fëmijët e të moshuarit, t'i ushqejnë ata në kushte të tmerrshme nëpër male, t'i bartin në shpinë e t'i strehojnë, të paarmatosura të vuajnë dhunën nga reprezaljet.

Mirëpo krerët e kësaj politike patriarkale nuk u kujtuan kurrë të shprehin mirënjohjen për sakrificën e këtyre grave që janë heroinat e vërteta të luftës. Ata vrapuan të shkruajnë historinë e bëmave të tyre, por kurrë nuk shkruan sakrificën e nënave, grave dhe motrave të tyre.

Është koha që ky mentalitet të ndryshojë, që ky Parlament të njohë kontributin e gruas në luftë dhe po ky Parlament të kërkojë drejtësi për viktimat e luftës mizore, të cilat janë në mesin tonë e që ne i kemi dënuar me heshtje.

Prandaj, duke marrë parasysh edhe kërkesat që u artikuluan në protestën e djeshme, unë në emrin tim personal dhe të lëvizjes “Vetëvendosje” kërkoj nga Parlamenti dhe Qeveria që të mbështesin në mënyrë publike e institucionale të gjitha gratë të cilat kanë përjetuar dhunim gjatë luftës. Ato gra të cilat e shprehin hapur dhe i qasen institucioneve për të kërkuar drejtësi, Qeveria duhet të vërë në lëvizje të gjithë mekanizmat ligjor e institucional për t'i dhënë atyre drejtësinë e merituar e të munguar prej kohësh.

Nga ana tjetër, Qeveria duhet të ngre me prioritet këtë çështje dhe Serbia duhet të pranojë që dhunimet kanë ekzistuar gjatë luftës dhe të ndërmarrë masa për dëmshpërblimin e tyre.

Tanimë që edhe Ligji mbi asistencën sociale është duke u rishikuar, ne kërkojmë që gratë e dhunuara gjatë luftës, të përfshihen në listën e veteranëve të luftës. Këto gra, sot më shumë se kurrë, duhet të marrin dëmshpërblimin material dhe moral të merituar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Aleancës, kush e do fjalën?

Deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete, deputetë,

Pa hyrë në historinë e kaluar të dhimbshme të popullit tonë e në veçanti për gruan e cila ka qenë pjesëmarrëse në të gjitha proceset e shoqërisë sonë, pa hyrë në ato dhimbje që janë shkaktuar më herët, konsideroj se më shumë fokusi jonë duhet të jetë në realizimin e të drejtës së gruas në shoqëri, në barazi që duhet të krijohet dhe kjo nuk krijohet as me lutje, as me kërkesa, as me ankesa, por bëhet me ligje, me Kushtetutë, me aktet më të larta të vendit, të cilat garantojnë barazi në shoqëri.

Prandaj, si shtresë e shoqërisë e goditur më herët rënd, tani duhet në proceset që po ecim, të ofrojmë mundësinë që gruaja të ndihet e barabartë dhe të ndihet e pozicionuar në institucione, në aktivitete të gjithmbarshme të shoqërisë dhe të jetë kreative e jetës së re në Kosovës.

Ligji i punës, i aprovuar në Parlamentin e Kosovës, më herët, është një ligj që mundëson vërtet një kujdes të veçantë, sidomos në punësimin, në të drejtën e realizimit të punës, por detyrë imediate është e Inspektoratit të Punës, që të shohë implementimin e Ligjit të punës në ndërmarrjet shoqërore, publike, private dhe të gjithë ato ku është gruaja e punësuar.

Po ashtu, duke u nisur nga roli i gruas edhe nga familja, nga shoqëria, nga institucionet ku ajo punon, ne mund të themi se kemi ecur përpara, por jo sa duhet dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, duke e parë këtë nevojë të domosdoshme të angazhimit të gruas edhe në Rregulloren e vet të brendshme, ka përparësinë që i jep gruas në avancim dhe po ashtu një barazi e cila mund të thuhet që është solide. Prandaj, konsiderojmë se edhe vlerat e së të kaluarës të cilat na barten si histori e si histori nganjëherë nuk po jemi në gjendje ta çmojmë ashtu si duhet, në gjithë Kosovën kemi monumente të heronjve, dëshmorëve, por mungojnë monumente të cilat vërtet do të kishin vlerësuar punën dhe luftën e gruas në shoqërinë tonë, siç kemi rastin e luftës së fundit, me Xhevdet Lladrovcin, Hanumshahe Abdullahun dhe shumë dëshmore tjera të cilat krah për krah me burrat e tyre kanë luftuar për vendin e që në të vërtet nuk u kemi mundësuar që në historinë tonë, me vlerat tona, të jenë të radhitura bashkë me meshkujt.

Po ashtu konsideroj se këto rekomandime, të cilat i ka ofruar Grupi Parlamentar i Grave, t'i përkrahim në mënyrë që vërtet gruaja të njihet e barabartë në shoqëri. Dhe, një gjë që do të doja ta theksoja me këtë rast, është se duhet të insistohet në mundësinë e vlerës që ka gruaja për t'u plasuar vetë më shumë me aftësitë, me guximin, me vizionin e vet dhe të mos lejojë që me çelës ose me mekanizma artificial të avancohen

në shoqëri, përkundrazi angazhimi i tyre i drejtpërdrejt, mundëson që vërtet të ndihen të barabarta, mundëson që të jenë në një shoqëri demokratike e cila pretendon në standardet më të arrira. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit,

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Përshëndetje për deputetët,

Duke marr parasysh se ky debat vjen pas një organizimi të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, përkrah debatin për pozitën e gruas në shoqërinë kosovare dhe duke marrë parasysh se ky Kuvend, në mandatin e kaluar, ka miratuar një Kushtetutë e cila parasheh që të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht gjinisë të jenë të barabartë para ligjit dhe ligjet të cilat i kemi miratuar në këtë Kuvend të Kosovës, për barazinë gjinore, mbrojtjen e gruas në familje, atëherë do të thotë se ne kemi një legjislacion të cilin vetëm duhet ta zbatojmë.

Esenca e debatit, duhet përqendrohet pikësëpari, femra në familje dhe gruaja në familje. Se a do të respektohet një femër në familjen e saj apo në rrethin e saj familjar, atëherë ajo duhet të përgatitet në të ardhmen për një jetën në të cilën duhet të sfidohet që nga vendi i punës apo në institucion arsimor, në institucion ekonomik, në institucion politik, në drejtësi dhe në të gjitha sferat e jetës kah kalon ajo.

Që të kemi një femër ashtu si mendojmë ne, me një përqindje si e parasheh Ligji për barazi gjinore, 40% të femrave në vendimmarrje, atëherë esenca është që vetë si familjarë ta përgatisim gjininë femërore që të jenë ashtu si u kërkuar edhe nga deputeti Ahmet Isufi, që ajo me vetë kontributin e saj dhe me punën e saj arsimore të arrijë aty ku e meriton në bazë të kualitetit të saj e jo në bazë të kuantitetit sa femra i kemi në Kosovë.

Çështja se sa ka arritur shteti i ri i Kosovës të përfaqësojë gruan në vendimmarrje, do të mbetet akoma sfidë, për arsye të kohës në të cilën kalon Kosova. Kosova kalon kohën e tranzicionit dhe pas kohës së tranzicionit, akoma duhet që feramat të punojnë vetë, të dinë çka të kërkojnë për gjendjen e tyre si në familje, si në shoqëri, si në rrethin ku punojnë dhe të kërkojnë zbatueshmërinë e ligjeve ku dihet mjaftë mirë se për çdo familje gruaja është ambasador i asaj familjeje. Ajo paraqet shtyllën e shtëpisë por njëkohësisht edhe paraqet zhvillimi e të ardhmes të asaj familjeje.

Me mundësi që mos të debatohet vetëm në aspektin se ne duhet të kërkojmë nga gjinia tjetër zbatueshmëri të ligjeve, respektim në familje, në shoqëri, ne duhet të punojmë që të gjitha gratë apo të gjitha femrat në Kosovë, kah do që të jenë ato, në qytete, në fshatra, që të jenë të barabarta para ligjit. Dhe, çështja e femrave që u potencua në rekomandimet të cilat janë nxjerrë nga mocioni, femrat të cilat i kanë kaluar traumat e kohës së luftës, atëherë ato të zbatohen nëpërmes të ligjeve që kjo një herë e

përgjithmonë të mbetet një e kaluar, por jo e harruar për gjeneratat e ardhshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputetja Mufera Shinik e ka fjalën:

Mufera Sinik: Teşekkür ederim.

Sayın Başkan, Sayın Bakanlar ve Milletvekilleri

Bugün bilhase daha fazla erkeklerin konuşmasını beklerdim.

8 Mart hepimizin bildiği üzere, ABD’nin New York kentinde dokuma fabrikasında işçilerin greviyle başlayan ve çoğu kadın 129 işçinin can vermesiyle sonuçlanan olay hafızalardan silinemez.

1910 yılında ve 1921 yılında Rusya’da, Danimarka’nın Kopenhag kentinde 8 Mart 1857 yılındaki olayın şanına Dünya Kadınlar Günü olarak anılma önerisi oy birliğiyle kabul edildi.

O gün bu gündür, 8 Mart Dünya Kadınlar Günü olarak kutlanmaktadır.

Aslında bu günü kutlama anlamıyla kabul ederken, dünyada cinsiyet eşitliğine, kadın haklarına, kadının eğitimde, sağlıkta, ekonomide, sosyal hayatta, siyasette ne denli eşit hakka sahip olduğunu araştırmak ve incelemek gerek.

Dünyada öyle demokratik ülkeler var ki, yasaya bağlanmadan, Parlamentoda kadınların sayısı, erkek milletvekillerinden fazladır, bu konuda örnek verebiliriz.

Bunun tam karşısında da dünyanın birçok gelişmemiş ülkelerinde kadınlara insandışı muameleler yapıldığı görülmektedir.

Böyle ülkelerde eğitimsizlikten kaynaklanan durumları ortadan kaldırmak için kadınların bilinçlendirilmesi, eğitime tabi tutulması ve ekonomi bağımsızlığını sağlamalı gerekmektedir.

Burada verilen istatistiklerden sonra ve konuşulanları tekrarlamamak şartıyla, dünyada kadının ne denli önem taşıdığını vurgulamak istiyorum.

Kadın bir insan, bir kız, bir anne, bir abla, bir eş, bir kardeş.

Bundandır Kosova yasalarına uygun bir şekilde olmakla birlikte, bilinç ve şuurla hareket ederek, toplumumuzda kadının yerini hakettiği seviyeye getirmek hepimizin ortak görevidir.

Bu hak aileden başlar, okul ve iş hayatına devam eder ve yeni nesillere taşınır.

Dünyaya genel baktıktan sonra, Kosovada kadın haklarını incelediğimizde, çok yeni ülke olmamıza rağmen, dünyanın birçok ülkesine nazaran Kosova çok demokratik, saygın ve hakeşitliğinin görüldüğü bir ülke olarak ortaya çıkmaktadır.

Yasalarla garanti altına alınmış temsiliyetten, kızların eğitime, kamuda istihdam oranı % 32-lerde dolaşırken, bilhase ilk öğretimdeki öğretmenlerde kadınların oranı erkeklere nazaran daha yükseklerde seyretmektedir.

Yasalarımızdaki % 30-luk karşı cinsten oranının, hem yasada % 50-ye taşımak için, hem de toplumda bu bilincin artması için, hem Kosova Meclisi Kadın Grubu, hem derneklerimiz, hem biret olarak elimizden geleni yapıyoruz ve elbirliğiyle kadınların çabası, erkeklerin desteğiyle başaracağız.

Fırsattan yararlanarak değerli hanımlarımızın 8 Mart Dünya Kadınlar Günü kutlar, saygılar sunarım.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit të SLS-së, a e do dikush fjalën? Jo.

Atëherë ia kisha dhënë fjalën deputetit Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoteni kryetar,

Zonja deputete,

Zoteni deputetë,

Unë do t'i them mendimet e mia për këtë çështje, duke u përpjekur të jem konkret, bile edhe duke përmendur emra.

Gjithkush prej nesh, të rinj e të vjetër e do dhe e dëgjon me dashuri të madhe këngën "Baresha" të Nexhmije Pagarushës e cila në të vërtetë është me status të himnit për jetën dhe kjo këngë, besoj që e dini, nis: "Hej kam rrit shtatin..." etj.

Kënga është një vepër kulmore, artistike, të cilën e kanë prodhuar dy vetë, një burrë edhe një grua, Rexho Mulliqi dhe Nexhmije Pagarusha. Nuk ka mund njëri pa tjetrin, kjo i bie se këto dy gjini funksionojnë, ekzistojnë, të arrijnë kulmet vetëm në raporte në mes veti, jo në kundërvuarje dhe një ta quaj unë garë qesharake karshillak kush po del i pari.

Tutje, shembulli i dytë, prapë thashë do të flas veç me emra, për të mos të përgjithësoj kot, kush e njeh Teatrin e Prishtinës e ka parë ose ka dëgjuar për shfaqjen kult "Erveheja" dhe Melihate Ajetin, mbretëreshën e skenës në rolin Ervehesë, në të cilën fiton moraliteti i gruas shqiptare përtej të gjitha intrigave burrërore e përtej burrërore. Prapë këtë shfaqje e kanë krijuar një burrë dhe një grua, Muharrem Qena, brilant, si regjisor dhe Melihate Ajeti, si mbretëreshë e skenës. Pra, kemi prapë një vepër kulminante, që e krijojnë, një burrë dhe një grua, sepse ndryshe s'mundet.

Shkojmë edhe më tutje, nëse doni sot, kush lexon letërsi e din vlerën e letërsisë së Hida Halimit, kush s' lexon, normalisht, s'e di se të gjithë nuk lexojnë çdo gjë. Kush merret me film, nuk mund të mos ta dijë për sukseset e zonjës Zeqiraj, kush dëgjon muzikë pop ose muzikë moderne aktuale, bile këto ditë, sigurisht kanë dëgjuar për Rita Orën, e cila është në krye të top listave. Po kalojmë e dhe në sport, e vetmja femër e Kosovës që ka normë olimpike, sot, është karateistja e Kosovës, është femër.

Pra, unë po bëj nderim në këtë bisedën time për femër, po edhe po bëj vetëm vlerësim, sepse nuk është femra në pozitën që të vajtohet për te, t'i dhurohet diçka ose t'i merret diçka. Më në fund, shoqëria është e lirë kur të gjithë i zhvillojnë kërkimet, interesat, afinitetet në mënyrë të lirë. Kurrkujt nuk mund t'i imponohet diçka në emër të nevojave të shoqërisë, shoqëria i rristrukturon nevojat e veta dhe gjinitë në bazë afeksioneve, ideve, mundësive. Unë, bile pasi po përmend emra, po shkoj edhe më konkret. Unë e kam para një Flora Brovina, shumë dimensionale dhe unë i them sot para jush, mua më vjen shumë mirë, ndihem mirë, zonja Flora, që mbas gjitha stuhive jemi bashkë e shoh edhe këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sepse është një jetë e tërë e kaluar dhe

ti e din që kolegët tu e të mi, një vit u çuditshin se të thosha - të kam kolege trefish, prapë mbetet trefish e ata që donë le ta gjejnë pse.

Dhe, unë dua të kthehem edhe një herë te fillimi, dua të kthehem te vargu i fillimit i këngës, unë edhe një herë po e them, antologjike të Nexhmije Pagarushës e të Rexho Mulliqit “Baresha” që fillon:”Hej kam rrit shtatin...” Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë që gruaja është mbretëresha e jetës, secilin prej nesh, në të gjitha kohërat e lind një grua. Kjo duket fakt i thjeshtë, po është esencial, ajo e mba jetë, të gjitha tjerat vijnë mbas asaj. Dhe, pika e dytë, edhe një herë gruaja është edhe mësuese e jetës. Jo vetëm pse fëmijët i lind e i rrit, po i edukon. Dhe, dua të vijë në atë që unë e quaj fundamentale, në shekullin tim jetësor dhe aktivitetin kulturor e krijues deri sot, janë gratë, mësueset më të mira që ka pasur ky vend në të gjitha aspektet dhe ato janë tash dhe edukatore të jetës dhe i përgëzoj të gjitha që kanë mësuar fëmijë të vet dhe të tjerëve, sepse abetarja është enciklopedi për fëmijë, siç është edhe enciklopedia për të rritur, abetarja. Këto i bëjnë femrat në mënyrën më të mirë se të gjithë.

Dhe, për të përfunduar këtë punën, raportin burrë e grua, sepse ky nganjëherë çoroditët nga dashuria për ta parë një garë disi të çuditshme qysh më duket mua, po hajt, që unë po e bëj pyetjen tash për meditim, a keni qejf ju të gjitha me ju quajt burrnesha dhe a kanë qejf meshkujt me i quajt granorë? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Filan e ka deputeti Halit Krasniqi, le të përgatitet deputetja Time Kadrijaj.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

E nderuara ministre Çitaku,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Kosova ka qenë e pushtuar nga disa pushtues, me përjashtim të pushtimit të fundit, me të gjitha vendet e popujt të këtyre pushtimeve, tani kemi një miqësi të shkëlqyeshme, me përjashtim të Serbisë, e cila derisa ende cenon sigurinë në veri të vendit tonë dhe derisa për të gjithë tragjedinë që ka krijuar këtu së bashku me kërkim falje, do t’ia kthejë Kosovës, viset e saja të aneksuara të Luginës së Preshevës, por kjo nuk është temë e imja sot. Me këtë digresion u shërbeva në hyrje për të tërhequr vëmendjen tuaj për atë që synoj ta trajtoj.

Në periudhën e gjatë të robërimit Otoman, për më shumë se 5 shekuj, dhe pastaj 100 vjet pushtimeve të ndryshme të Beogradit, nuk shquhet asnjë femër e këtyre pushtimeve në krijimin e politikave pushtuese, as në ekzekutimin e dhunës. Edhe ky është një shembull që tregon fisnikërinë e gjinisë femërore dhe tiparin e saj të shkëlqyer si qenie njerëzore. Ky virtyt i femrës, është edhe në historinë e pushtimeve malazeze, bullgare, greke, naziste dhe fashiste, gjatë të cilave femrën nuk mund ta gjejmë as në krijimin e politikave pushtuese, as të ato ekzekutuese dhe jo vetëm këtu në Kosovë, por as edhe ndonjë vend tjetër të këtyre kujtimeve të këqija gjatë trandjeve në sistemin e vlerave njerëzore.

Ndërsa, shembuj tjerë konkret dhe shkëlqyes të femrës sonë, mund t'i rendis që nga mbretëresha Teutë e deri te Shotë Galica dhe plejada e luftëtareve të Luftës së Dytë Botërore. Për hir të vendit dhe të rendit, do t'i përmend telegrafikisht personalitetet që pas ripushtimit nga Beogradi me 1945 e deri në ditët tona, duke filluar me Marije Shllakun, e dënuar me vdekje në gjykatën e parë pushtuese, këtu në Kosovë, për të vazhduar me Hyrie Hanën dhe veprimtarët tjerë që kontribuan jashtëzakonisht shumë në lëvizjen ilegale për çlirimin e Kosovës, në një kohë zezonë për të mbajtur gjallë frymën e lirisë dhe për ta forcuar e rrit idenë e çlirimit.

Për këtë kontribut u ndëshkuan, u ndoqën me burgje e tortura, pa u thyer e pa u penduar asnjëherë, përkundrazi, krenaria i shoqëroi gjatë gjithë jetës së tyre edhe ato që janë gjallë, kjo cilësi i tipizon. Në këto ecejake historike dhe përpjekjet titanike në një rrugë të rëndë dhe maratonë, plejada tjetër veprimtareve në lëvizje popullore për çlirim, do të shquhet me përplasjen e tyre burgjeve, me ndjekje dhe që sot, është momenti për t'i përmendur në shenjë respekti dhe falënderimi për rolin e tyre që kanë luajtur dhe për guximin e gatishmërinë që kanë treguar në atë kohë dhe për përjetimet dhe vuajtjeve të tmerit si nëpër rrathët e Dante Aligerit.

Do të filloja duke renditur me mbiemra vajzërie që kanë ngelur në memorien time që atëherë, si: Drita Kuçi, Teuta Hadri, Trendelina Labinishti, Nazife Xhemajli, Gjyle Krasniqi, Shyhrete Mala, Have Shala, Kile Dedinca, Myrvete Dreshaj, Shukrije Gashi, Hydajete Osmani, Hydajete Krasniqi, Ajshe Gjonbalaj, Kadrije Gashi, motrat Gosalci, motrat Demaku, Sadete Zhitija, Sala Berisha, Nexhmije Jashari, Bulja, Saime Isufi e njohur, e shumë veprimtare të tjera të devotshme të cilave u kërkoj mirëkuptim që do t'i lë një herë tjetër t'i përmend ashtu si e meritojnë, për të vazhduar me veprimtarët, tani dëshmorë dhe heroina: Xhevë Krasniqi- Lladrovci, Hyrë Emini, Heteme Emini, Luljeta Shala, Hanumshahe Avdullahu e të tjera heroina që kanë thur një rol, rolit të femrës, në një moment sfidues dhe në një kohë të papërsëritshme.

Femra e këtij vendi ka shfaqur rrezatimin e tipareve mbresëlënëse edhe në format tjera inspiruese dhe për respekt, si nëna Nazife Demaçi, e cila i tha djalit të hasretit: “mos ju ndajë nënës së madhe nga është atdhe, sepse unë të lë një ditë, por ajo nuk të le kurrë” Pa u penduar asnjëherë, rrugëve të burgjeve për ta takuar djalin një orë të vetme, për 20 vjet sa jetoi dhe nuk kishte pendesë as në momentin kur mbylli sytë, pa djalin e vetëm i cili i kishte edhe 8 vjet e tjera për ta përfunduar dënimin.

Këso shembuj gjen në një armatë të tërë të nënave, të motrave që janë zhuritur rrugëve të gjata për në burgje e kazamate nga Idrizova e deri ne Goli Otok, për më shumë se 50 vite. Këtu do të duhej shquar Shukrije Osmanin që për 20 vite priti bashkëshortin e saj të dënuar sikur edhe mijëra gra të tjera që pritën bashkëshortët e tyre të dënuar dhe me shumë siklete rritën fëmijët e tyre duke i ushqyer, përveç me bukë e ujë dhe me mbrujë e krenari.

Ndonjëri nga këta fëmijë, me prirje letrare do t'i portretizojë nënat e tyre në personazhe edhe më shkëlqyese se Penelopa e Omerit. Me këtë rast nuk mund të mos

kujtoj gra, vajza demonstruese, pa asnjë mashkull, me rastin e vrasjes së studentit, Armend Daci dhe për të vazhduar kujtimin për demonstrueset tjera, që përkrah djalërisë, demonstruan vazhdimisht, sa herë që është demonstruar që nga demonstratat e 1968 e deri në demonstratat e fundit, për të shprehur simpatinë për Luftën e UÇK-së.

Këtu, në këtë vend dhe sot, në këtë ditë, nuk mund të mos e përmend dhe nuk bën të mos të kujtojmë me pietet nënëmadhen Ajshe Gërvalla, e cila i portretizoi për mrekulli nënat tona të brezit të brezit të saj dhe të brezave tjerë që nuk patën fatin të arsimohen, por rrezatuan arsimim përmes intuitës, edukatës dhe integritetit etik, të formësuar nga sistemi i vlerave të shkëlqyeshme të traditës sonë unike, që fal këtyre karakteristikave edhe rezistuan nëpër shekuj robërie.

Nuk mund mos e përmend rolin e nënës së djemve legjendar, Zahide Jashari, me gra e vajza heroina të familjes së madhe të Jasharëve mitikë deri te nëna Salë, për t'u ndalë te nënat që kanë dhënë djemtë e hasretit si Xhemile Sopi, nëna e Sokol Sopit, nëna e Ilir Durmishit dhe nënat tjera të dëshmorëve të hasretit. Gjithashtu me këtë rast, në këtë ditë do të përmend nënën Rukë Haredinaj, e cila në momentet e rënieve ciklike të djemve të saj dëshmorë dhe gjatë evokimit të kujtimit të tyre momenteve, ka portretizuar e përjetësuar nënat tona stoike sot e nëpër shekuj si legjenda tipike, duke ngurtësuar dhimbjen e natyrshme amnore. Gjithashtu për këtë tipar do t'i kujtoj nënat e mbi 2000 dëshmorëve të kombit që me bindje intuitive kanë përvetësuar misionin e jashtëzakonshëm për të ngurtësuar lotin dhe për ta mundur dhimbjen me mburrje e krenari për shërbimin që ia kanë bërë atdheut dhe lirisë së tij. Sot dhe këtu, do të përmend dhe për ulje dhe respekt për ato gra të dëshmoreve që me shumë vështirësi rrisin e përkujdesen për fëmijët e tyre bonjak, duke ua mbjellë mburrjen dhe duke i edukuar me krenari që duhet t'i shoqërojë deri në formësim për baballarët e tyre dëshmorë.

Me respekt të madh dhe të veçantë do t'i përmendim nënat dhe gratë e mbi 10.000 martirë të vrarë dhe të zhdukur, të cilat kanë mundur dhimbjen dhe që po rrisin fëmijët e tyre me shumë vështirësi duke i ushqyer me krenari dhe bindje, se të gjithë ata martirë kanë qenë në shërbim të lirisë së sotme. Sot, do ta përmendim rolin e femrës në uniformën e UÇK-së, të cilat, jo vetëm që i rritën namin vetit dhe këtij vendi, por i kanë bërë nderë një kauze që solli në këto momente për të diskutuar për rolin e gjinisë së tyre edhe përfaqësimin e tyre edhe në këtë Parlament.

Nuk do të na fal Zoti të mos ndaleshim në rolin e femrës që luajti ajo gjatë luftës, jo vetëm për ushqim dhe përkujdesje të tjera të domosdoshme, por edhe për një rol të veçantë që luajti në përkujdesjen e fëmijëve gjatë gjithë luftës pa burrat e tyre, sa nëpër male e këndeje e sa me peripeci nëpër Shqipëri, Mal të Zi dhe nëpër Maqedoni.

Në kohë lufte dhe në kohë paqe, roli i femrës mantel bardhë është i jashtëzakonshëm, i madh dhe i pa zëvendësueshëm në shërbimin shëndetësor. Faleminderit prej Zotit që kemi një numër mjaft të madh dhe një kuadër të përgatitur dhe mjaft të përkushtuar dhe me ndërgjegje. Roli i femrës në administratë dhe në institucionet shtetërore dhe private është jashtëzakonisht i madh, duke ndikuar jo vetëm në efikasitet, por edhe në

performancë. Këtë rol me këto dy cilësorë, roli i femrës do të mund të përshkruhet edhe në uniformën e FSK-së edhe Shkërbimin Policor. Sot femrën e gjejmë edhe një rol të konsiderueshëm në sport, kulturë, shkencë dhe është duke krijuar identitetin e vet në të gjitha fushës e dijës.

Gjithashtu sot, femrën e gjejmë në përpjekje të marrjes së dijes nëpër amfiteatrot e universiteteve, me pretimin për t'u integruar nesër në institucionet e ndeshje dhe për t'i dhënë shoqërisë një shtytje të hovshme. Gjinia femërore sot prezantohet jashtëzakonisht mirë edhe suksesshëm në të gjitha mediat e shkruara dhe elektronike dhe si analiste, si hulumtuese e guximshme dhe si editore, menaxhere e pa konkurrencë. Nuk do të duhej të mos përmendi Flora Brovinën, si personalitete të veçantë e deputetet tjera që kanë kaluar nëpër të gjitha legjislaturat e deri te kjo përbërje sot, që kanë kontribuar dhe po kontribuojnë me përkushtim e dinjitet dhe gjithnjë duke qenë më koshiente se ne burrat e Parlamentit, me gjuhën e përdorur, me trajtimet e temave dhe me nivelin e përkushtimit të tyre. Përbledhurazi edhe në fund të kësaj fjale, për hir të një projekti për ardhmërinë, që nuk duhet të eci me njërën këmbë dhe nuk duhet të veproj vetëm me njërën dorë, rrjedhimisht për ta aktivizuar gjithë forcën tonë, duke nxitur, duke aktivizuar, duke inkurajuar e duke motivuar femrën tonë, do të vëmë në lëvizje gjithë potencialin e trupit të shoqërisë sonë që përbëhet nga të dy gjinitë, dhe vetëm duke aktivizuar bashkërisht dhe barabarsisht që të dy gjinitë, neve kemi perspektivë të ndritshme.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Time Kadrija, le të përgatitet Emilija Rexhepi.

TIME KADRIJAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Kosova kaloi nëpër dekada të përgjakshme gjatë shekullit që e lamë pas. Dhjetë vjetësh i fundit ishte më vendimtari për fatin e shqiptarëve në Kosovë dhe secila luftë në këtë truall, lindi heronjtë e vet që shkruan historinë e shqiptarëve, me gjakun e tyre të njomë, duke filluar nga epoka e lavdishme e Skënderbeut, Lidhja e Prizrenit, luftërat ballkanike e deri te lufta e fundit e UÇK-së.

Gruaja dhe nëna shqiptare, jo pak herë u përballë me ashpërsi të jetës. Mbi të rëndoi pesha e shekujve të robërisë dhe varfërisë, pesha e kanunit dhe padrejtësisë, kobi e zia, loti dhe gjaku, por për asnjë çast ajo nuk u nënshtrua para sfidave të shumta gjatë jetës.

Dinjitetin dhe krenarinë e saj nuk e mposhti as robëria shekullore e as goditjet e njëpasnjëshme që ajo i mori nga ashpërsitë e jetës së rëndë e me plotë halle. Gruaja dhe nëna shqiptare në vend të parfumeve evropiane, përdori barotin, stolitë e saja ishin koburja dhe gjerdani me fishekë, ajo ishte dhe mbeti në shërbim të atdheut.

Gruaja shqiptare si nënë, atdheut i fali shumë ushtarë lirie, i fali zana mali si: Teuta, Nora, Tringa, Shota e deri tek Xhevë Lladrovci, ditëve të sotme, Myrvete Maksutaj, Hyre Emini dhe padyshim nënmëdhajat Zahide Jashari dhe Aze Ibrahimaj e shumë dëshmore të tjera.

Nënat tona gatuan bukë për çlirimtarët, thurën çorapë që mos të ngrihen ata, i bekuan rrugët e tyre të përgjakshme, i puthën ata në ballë duke ua dhënë uratën në rrugët tona të vështira, por të lavdishme të lirisë. Ato i vizituan bijtë e tyre nëpër burgje dhe kazamatet serbe, duke u dhënë forcë dhe bën që populli ynë të triumfojë fuqishëm mbi tmerrin shekullor të robërisë, mbi planet asimiluese që pushtuesit tanë i zbatuan egërsisht mbi popullin shqiptar.

Nuset e reja i pritën trimat e tyre me vite të tëra nga syrgjinet, nga internimet, nga burgimet, ato u gjakosën krah burrave për këtë tokë të zhuritur, ato hyjnë në histori me qëndresën detyre. E kur bijtë tanë u kthyen të gjakosur nga lufta, fjala e nënës ua shëroi plagët, ato nuk lejuan që loti t'iu shkojë në faqet e tyre të ndritura, jo, asnjëherë.

Po cilat nëna në botë janë më të sprovuara, më të forta më bujare se nënat tona? Ishte nëna dhe gruaja shqiptare ajo që i rezistoi të gjitha këto dhe nuk u dorëzua. Asaj dhe vetëm asaj i dedikohen të gjitha, para së cilës populli ynë me respektin më të madh, duhet të përkulet deri në gjunjëzim, para qëndresës dhe të heroizmave të nënës shqiptare.

Në rrugën e stërgjatë të historisë së popullit shqiptar, meritat e gruas shqiptare zënë një kaptinë të veçantë. Ajo e bëri këtë përmes edukimit të gjeneratave, edukim ky që ia nisi nga ninullat e para dhe mbajti frymën liridashëse, kultivoi ndjenjat e mosgjunjëzimit dhe të respektit ndaj vlerave kombëtare e njerëzore.

Nënat tona nuk festojnë 8 Marsin, Ditën Ndërkombëtare të Gruas, lule i dërgojnë në ditëlindje dëshmore, përvjetorë vrasjesh, masakrash dhe me lule stolisin varret e djemve dhe vajzave të lirisë. Ato stolisin me lule komplekset e dëshmorëve në Prekaz, Glogjan, Koshare dhe çdokund ku është një varr dëshmori. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Për t'ju përshtatur kërkesës së Grupit të Grave Deputete, i kisha përkujtuar deputetët edhe deputetet, se nuk jemi duke folur për heroizmin e gruas ndër shekuj, mendoj që tema është shumë konkrete dhe ju kisha lutur të flisni për temën për të cilën jemi thirrur sot.

Unë pata respekt dhe nuk ndërhyra në disa fjalë, po realisht ato fjalë që u thanë, janë krejt jashtë rendit të ditës dhe jashtë çështjes për të cilën sot është thirr kjo seancë. Ju kisha lutur të jeni në temë.

Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi, le të përgatitet deputeti Agim Kuleta.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedniče!

Poštovani predstavnici Vlade,

Poštovani poslanici,

Pripadnike lepšeg pola, koleginice,

Jako nam je važna institucionalna podrška Vlade u vezi položaja i prava žena u kosovskom društvu.

S obzirom da je Kosovo, odnosno naša država zemlja koja je u tranziciji i mi kao poslanici smo odgovorni i snosimo obavezu kako će se to reflektovati na socijalizaciju celokupnog društva. Danas imamo jednu jaku važnu temu koja proističe znači iz naših zakona i obavezni smo da to sprovodimo u saradnji sa celokupnim civilnim sektorom sa nevladinim organizacijama, te u taj i sve ostale koje su ovo podržale i dale danas da se raspravlja u toj temi. Jako je bitno, a moj osob biće na, pre svega na diskriminaciji žena u javnom životu, na emancipaciji, na edukaciji žena. Znači, želim istaći pozitivnu diskriminaciju, možda nije diskriminacija ali jeste prvi korak koji je učinjen da mi u izvršnoj vlasti imamo dve ministarke, imam našu predsednicu, ali gospodo i dalje nemamo nijednu pripadnicu lepšeg pola, odnosno nijednu predsednicu opštine, koliko mi opštine imamo na Kosovu, nijednog predsednika nemamo da je to žena. Zatim jako je bitno da istaknemo da su visoke funkcije, znači pojedinih direktorijata, kordinatora, šefova, jako teško za pripadnice lepšeg pola.

Mislim da bi smo mi institucionalno trebali preraditi na svemu tome da se implementacija Zakona o ravnopravnosti polova sprovodi onako kako bi trebalo da u saradnji sa nevladinim organizacijama koje rade na emancipaciji žena po ruralnim mestima, s obzirom da smo društvo koje je i dalje patriarhalna sredina, znači način života na jako niskom nivou tako da svi mi želimo dati doprinos u tome i biti odgovorni za socijalizaciju našeg društva.

Ono što je bitno jeste ta ekonomska perspektiva žena, odnosno njihova edukacija, tako da s obzirom da je žena stub jedne porodice ona je i stub jednog društva. Moramo sa nekim pozitivnim aspektima gledati na svemu tome za to što je i žena odgovorna za vaspitanje svoje dece a to znači da celokupno društvo može snositi posledice.

Ekonomska egzistencija jedne porodice dovoljno zavisi i od toga da li supružnici rade, tako da danas u ovim modernim vremenima ukoliko ta edukacija nije na zadovoljavajućem nivou, znači obrazovanje ženske dece, gde bi ja stavila fokus i apel Ministarstvu za obrazovanje da vrši i dalje te edukacije u saradnji sa nevladinim sektorom po ruralnim sredinama, jeste od prioritete važnosti za celokupno naše društvo.

Još jednom kažem da podržavamo inicijativu žena u Parlamentu Kosova, i ne samo da se čuje naš glas samo kad nam treba 30% kvote ili kvoruma, da mi budemo u jednom parlamentu. Mislim da smo i po tom pitanju se osaćamo diskriminisanim, jer nekad mi sami sebi postavljamo taj kvorum. Tako da još jednom zahvaljujem se vama predsedniče, što ste nam udovoljili da danas raspravljamo o svemu tome.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti, Agim Kuleta! Le të përgatitet, deputetja Teutë Haxhiu!

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja dhe zotërinj,

Aktivistja afrikano-amerikane e të drejtave civile Rosa Parks, e cila nga Kongresi Amerikan njihet edhe si zonja e parë e të drejtave civile, në një kohë shumë të rëndë për shoqërinë amerikane u përball në të njëjtën kohë me dy sfida shumë të vështira.

Ajo me guximin e saj të munguar, sipas mentalitetit shoqëror, arriti ta sfidojë si orientimin diskriminues gjinor të shoqërisë, ashtu edhe ligjet raciste të shtetit.

Ajo refuzoi tu largohet problemeve, largim që ishte i mundshëm vetëm duke paguar çmimin e nënshtrimit ndaj përbuzjes. Ajo vendosi të paguante diçka tjetër. Ajo u përcaktua për çmimin e lirisë dhe dinjitetit, çmim që nënkupton përpjekje, vuajtje, sakrifica dhe vetëmohim. Dhe, sot si rezultat i pagesës së këtij çmimi, Amerika është një vend më i mirë se dje, ndërsa nesër do të jetë një vend më i mirë se sot. Dhe, është kështu falë edhe forcës së një komuniteti, që bota është mësuar ta thërrasë me emërtimin “gjini e brishtë”, e të cilit i takonte edhe Rosa Parks.

Pikërisht, “brishtësia” në thonjëza e kësaj zonje, përballë kokëfortësisë së çeliktë të realitetit, është dëshmia më e mirë për paqëndrueshmërinë e këtij emërtimi si koncept.

Po, cila është Rosa Parks në shoqërinë tonë? Fatmirësisht, jetojmë në një kontinent, dallgët civilizuese të të cilit është vështirë të përballohen nga brigjet e lëkundura të prapambetjes. Këtu jeta e Rosa Parks është më e mirë se sa që ishte pak kohë më parë, por që padyshim nuk është aq mirë sa do të duhej të ishte sot.

Megjithëse, ajo ka arritur të prekë lartësi më të mëdha se dje, beteja e saj nuk përfundon këtu. Ajo duhet të vazhdojë të përpiqet që ta zgjerojë atë edhe më tepër. Vetë ekzistenca e kësaj përpjekjeje të saj dëshmon se shoqëria jonë ende vuan nga të mos qënurit mirë dhe përmirësimi i kësaj shoqërie duhet të fillojë nga identifikimi i problemit të vërtetë të saj, i cili shpeshherë di të huqet.

Në fakt, problemi i vërtetë i shoqërisë sonë nuk është gruaja, është burri. Prandaj, përpjekja jonë kryesore si shoqëri, nuk duhet të përqendrohet në emancipimin e gruas, por në emancipimin e burrit. Sepse, pikërisht mentaliteti i prapambetur e egoist i burrave, është pengesë për përparimin e grave.

Përkrahja e burrit për gjininë femërore nuk duhet të konceptohet si ndihmë për të, por për vetveten. Gjinia mashkullore është në një krizë dramatike, e cila po reflektohet përmes vështirësisë së madhe për tu liruar nga prangat të cilat ajo ia ka vendosur vetes. Pra, nga egoja e vet.

Si pasojë e kësaj egoje, po vuan një shoqëri e tërë. E duke qenë edhe vetë pjesë e kësaj shoqërie, pa e kuptuar shkakun, po vuan edhe vetë ai.

Pra, si mund të presim që të zhvillohemi si shoqëri kur lejojmë që gjysma e potencialit tonë, pra gratë, në vend se të përpiqen me tërë kapacitetin e tyre për daljen e shoqërisë sonë, si tërësi, nga margjinat rajonale evropiane janë të detyruara të harxhojnë energji për dalje nga margjinat brenda shoqërisë sonë, ku padrejtësisht vazhdojnë të mbesin të ngujuara.

Zonja dhe zotërinj,

Rosa Parks u përball me dy sfida në të njëjtën kohë dhe këtë e bëri në një kohë shumë të vështirë. Sot, gratë në Kosovë përballen vetëm me një sfidë: mentalitetin nënçmues të shoqërisë ndaj tyre dhe këtë, për fat të mirë, e bëjnë në një kohë më të lehtë.

Megjithatë, si për Rosa Parks-in amerikane, po ashtu edhe për atë shqiptare, është vetëm një gjë që ka garantuar e garanton sukses. E ajo është vendosmëria për të mos u dorëzuar para realitetit hipokrit.

Tani më lejoni, që nga ky vend t'i inkurajoj të gjitha gratë e nënat tona të dashura që të vazhdojnë të përpiqen pandërprerë për avancimin e rolit të tyre në shoqëri, deri në atë shkallë, që akti i dhurimit të luleve për to të mos jetë vetëm respekt për ato që pranojnë këtë dhuratë, por edhe privilegj për ata që e japin atë.

Të punojmë së bashku me vetëmohim, derisa të arrijë ajo ditë, kur momenti i lumtur për prindërit, ai i lindjes së një vajze, të mos cenohet nga brenga për të ardhmen e saj në shoqërinë, të cilës i përket.

Tani, ju lutem, më lejoni që në shenjë respekti, për gratë deputete të Kuvendit të Kosovës dhe për të gjitha gratë dhe nënat, këtu dhe në gjithë botën t'ua dhuroj një buqetë lule, deputetes Teuta Sahatçiu, si udhëheqëse e Grupit të Grave deputete të Kuvendit të Kosovës dhe këtë jo për 8 Marsin si ditë e grave, por për respekt ndaj përpjekjeve dhe angazhimit të tyre në avancimin e shoqërisë, në përgjithësi.

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja, Teutë Haxhiu dhe pastaj do t'i them disa fjalë edhe unë.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Që në fillim dua t'i falënderoj të gjithë ata deputetë që e kanë përkrahë mbajtjen e një seance të tillë, por njëkohësisht edhe të gjithë ata që kanë pasur vullnetin, që e përmendi edhe kryetarja e Grupit e që nuk kanë pasur mundësi të nënshkruhen.

Ta mbash një seancë të këtillë, nuk do të thotë që ne po kërkojmë të drejta më të mëdha si deputete, por po kërkojmë për të gjitha femrat, se ne jemi vetëm një zë i femrave të shumta e të shumta, që janë mbi 50% të përbërjes së shoqërisë sonë, pra në Kosovë.

Prandaj, më lejoni që ta filloj këtë fjalim, dhe po mundohem ta bëj shumë të shkurtër, që 8 Marsi dita ndërkombëtare e gruas festohet në gjithë botën vite e dekada me radhë. Dita ndërkombëtare e gruas shërben, jo vetëm për bashkimin e grave, pa dallim feje, race, kulture, gjinie, gjuhe apo prejardhje, por është edhe për të kujtuar përpjekjet për barazi, paqe, drejtësi dhe ndërtim në gati nëntë dekada gjithandej rruzullit tokësor.

Padyshim, edhe gruaja në këtë rol është përballur me sakrifica, ndryshime dhe progrese dhe ka hapëruar krah me mashkullin. Respekti për femrën është respekt për jetën, është respekt për familjen shqiptare që asnjëherë nuk u gjuhëzua para sfidave të kohës, falë dashurisë së saj për njeriun, këmbënguljes dhe përkushtimit të saj për një familje të shëndetshme, në shërbim të atdheut dhe njerëzimit anëmbanë.

Megjithëse gjysma e popullsisë në moshë madhore, gati në çdo vend në Botë përbëhet nga gratë, ato zënë një vend të vogël në përbërjen e shumicës së qeverive. Kjo, fatkeqësisht po ndodhë edhe nëpër institucionet tona. Kjo është për të ardhur keq, pasi që gratë mund të kenë shumë njohuri të theksuara, në shumë fusha e në mos shumicën e çështjeve politike-bërjes, që prekin ato drejtpërdrejtë.

Shtatzënia dhe shëndeti i fëmijëve, për shembull, prekin në mënyrë të veçantë gratë, por ato janë me rëndësi për mirëqenien e gjithë shoqërisë sonë. Kjo nuk do të thotë, domosdoshmërisht që duhet të kemi vetëm gra që të bëjnë politikat publike, por do të thotë se kemi nevojë për njerëz që janë të ndjeshëm ndaj shqetësimeve të grave.

Në mënyrë të ngjashme, gratë që punojnë, kanë një vështrim të veçantë mbi drejtpeshimin e punës dhe familjes dhe jetës së tyre. Në nivelin lokal, problemet sociale, duke përfshirë këtu edhe varfërinë dhe pasojat e saj si trajtimi dhe kufizimi i mundësive për arsimim, ndjehen shumë thellë. Këtu nevoja për pjesëmarrjen e grave, si nëna dhe si drejtuese të komunitetit, është me rëndësi thelbësore.

Edhe Dita ndërkombëtare e gruas është një moment i mirë për t'i theksuar dy çështje, që nuk presin dhe që janë shqetësim i veçantë për gratë. Dhe, këto janë:

- Informimi i grave për kancerin e gjirit dhe trajtimi i tij, si dhe
- Trajtimi i çështjes së dhunës kundër grave.

Pjesëmarrja dhe arritja e barazisë gjinore në pjesëmarrjen e grave në politikë, biznes dhe në jetën shoqërore ka qenë e mbetet një sfidë dhe betejë sfiduese në mbarë botën.

Prandaj, hapja e politikës për një pjesëmarrje më të thellë të grave është vetëm një pjesë e kësaj përpjekjeje. Gratë duhet të luajnë një rol të barabartë edhe në jetën ekonomike të gjithë vendit.

Përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në një shoqëri, nuk ka të bëjë vetëm me gratë, por ka të bëjë me drejtësinë dhe sensin e së duhurës. Ka të bëjë me begatinë e vendit. Asnjë vend në botë, ndërkaq as vendi ynë, nuk mund t'ia lejojë vetes mospërkrahjen e talentit të gjysmës së popullsisë së tij, siç janë nënat, motrat dhe bijat tona.

Dhe, krejt në fund, të pajtohesh me atë që ke, do të thotë, të stagnosh në vend. Kërkimi për avancim të mëtejshëm të grave në institucionet e vendit, është dhe duhet të jetë objektiv i shoqërisë sonë. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

(Drejtimin e seancës e merr zoti Sabri Hamiti nënkryetar i Kuvendit të Kosovës)

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi!

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë e deputete, Vërtet, sot kemi në shqyrtim një temë mjaft të ndjeshme dhe të ndjeshme jo vetëm për shoqërinë tonë, por edhe për shoqërinë në nivel ndërkombëtar. Dhe, sigurisht që ne këtë temë duhet ta trajtojmë nga një kënd për shoqërinë tonë, se çka sot të bëjmë për gruan, çka të ndryshojmë, çka mund të ndryshojmë dhe si t'i përgatisim nga sot parametrat për një shoqëri, që njerëzit i trajton në mënyrë të barabartë, si meshkujt ashtu edhe femrat. Unë mendoj, që kjo duhet të jetë tema e trajtimit të sotëm.

Ne e dimë që edhe në nivel botëror, kjo çështje është një lloj prioriteti. Kemi Deklaratën e mileniumit dhe ne para pak viteve e kemi miratuar një Rezolutë. Kemi Kushtetutën, në të cilën të drejtat e gruas dhe të burrit janë të barabarta. Kemi edhe ligjet, që gruaja është e barabartë. Mirëpo, shumë më lehtë është t'i shkruajmë në rezoluta, në kushtetuta dhe në ligje të drejtat dhe liritë e njeriut në përgjithësi, e të gruas në veçanti, por vështirësitë gjithnjë vijnë atëherë kur duhet të zbatohen dhe konkretizohen në jetë.

Unë jam i bindur se kërkesa e Grupit të grave deputete nuk është kërkesë për privilegje të gruas në shoqëri, por është kërkesë për një trajtim të barabartë në gjithë jetën shoqërore dhe politike në Kosovë.

Dhe, nga duhet t'ia nisim, që vërtetë gruaja të jetë e barabartë në shoqërinë tonë, ose të ketë trajtim të barabartë në shoqërinë tonë, ose qasje të barabartë në jetën politike, institucionale dhe publike?

Unë konsideroj se duhet filluar nga edukimi në familje, që ndoshta nuk mund të bëhet shumë por duhet ta shikojmë se cili është roli i shkollës, i edukimit dhe i arsimit në këtë rrafsh, në rrafshin e qasjes së barabartë të gjinive. Pra, konsideroj, që në këtë rrafsh, shkolla jonë do një reformim ndryshe. Dhe, shkolla jonë duhet të shikojë a na e ka krijuar jo vetëm një trajtim njerëzor ndaj gruas, se në fund të fundit, një shoqëri që nuk e ka një arsim dhe një edukim për të krijuar personalitete me integritet, qoftë të burrit, qoftë të gruas - është vështirë ta kemi atë shoqëri që ne e dëshirojmë.

Po ashtu, konsideroj se pa e nënvlerësuar atë që na e ka pru historia, ne si komb dhe si shoqëri, kemi nevojë për një edukim dhe arsim që na i krijon njerëzit me integritet, dhe jo vetëm në shoqëri në përgjithësi në Kosovë, konsideroj se integriteti i veprimit na mungon edhe në Kuvendin tonë e pastaj zbret në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Përveç kësaj, realisht diçka për sferën ekonomike, me ligje kemi bërë. Por, sa është e përfaqësuar në jetën ekonomike, sa është e pavarur në jetën ekonomike në shoqërinë tonë gruaja - kjo është një çështje që lë për të dëshiruar shumë, dhe ne si shoqëri duhet të punojmë shumë.

Cila është qasja e gruas në drejtësi por edhe e drejtësisë ndaj gruas? Në kohën kur dihet që ekziston një dhunë në familje, ne nuk mund ta fusim kokën në zall dhe të mos shohim. Kjo shoqëri vuan edhe nga dhuna në familje dhe duhet që sistemi i drejtësisë të bëjë diçka më tepër për të ndryshuar qasjen e kësaj shoqërie dhe të njeriut si individ, ndaj të drejtave dhe lirive të gruas.

Unë po e mbyll, me një thënie të antikës, kur dy filozofë bisedojnë në mes vete dhe njëri e pyet tjetrin:

- Cili qytet në Greqi i ka qytetarët më të kulturuar?

Përgjigja është:

- Qytetarët më të kulturuar, i ka ai qytet nëse ata qytetarë dinë të reagojnë edhe ndaj të padrejtave që iu bëhen të tjerëve.

Pra, mendoj që në shoqërinë tonë duhet ta kemi këtë edukim, që të dimë të reagojmë ndaj padrejtësisë që i bëhet tjetrit dhe në këtë rrafsh, ndoshta zëri pak më i ngritur i yni duhet të jetë ndaj padrejtësisë, që në shumë segmente i bëhet gruas sonë, që në fakt unë jam dakord me atë historinë që u shpjegua këtu, por ne kemi obligim ta ndryshojmë të sotmen dhe të ardhmen. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zotni kryetar! Fjalën e ka Donika Kadaj-Bujupi!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Do të provoj që të jap kontributin tim dhe të jem më pragmatike në këtë debat, në këtë diskutim, sepse në rend të parë konsideroj që është goxha problem me bë ndarje të një komuniteti në shoqëri, në një shoqëri siç është Kosova, përderisa problemet dhe sfidat janë të shumta për të gjithë qytetarët e saj.

Unë mendoj, që mungesa e një strategjie pak më specifike për një plan zhvillimor ka shkaktuar ngecje të mëdha në shumë sektorë, të cilët potencialisht do të mund të shfrytëzoheshin për absorbimin e kapaciteteve të Kosovës, qoftë të kapitalit njerëzor, e këtu hyn edhe 50%-shi i popullsisë që ka mbetur anash, apo i burimeve natyrore.

Në këtë situatë të vështirë, ku papunësia, varfëria, sundimi i ligjit janë disa nga sfidat që na preokupojnë, gjendja e gruas është edhe më e rëndë, për shkak të specifikave që ka.

Në rend të parë, këto specifika lidhen edhe me traditën dhe të kaluarën, mungesën e zbatimit të ligjeve dhe s'kemi nevojë të konstatojmë për gjendjen sepse jemi të vetëdijshëm, kjo u tha edhe nga parafolësit edhe nga vetë kryetari i Kuvendit, që në të shumtën e rasteve kemi nevojë të reagojmë më shpejtë dhe më mirë në mënyrë që t'i zbatojmë ligjet ekzistuese për ta përmirësuar gjendjen e gruas në Kosovë.

Unë, duhet të ritheksoj edhe një herë, që pasqyra e gruas së Kosovës nuk është në Prishtinë. Nëse shkojmë nëpër fshatra, nëpër zona rurale do ta kuptojmë se gjendja e saj dallon shumë. Është shumë më e vështirë dhe më e rëndë dhe se problemet me të cilat ballafaqohet ajo janë krejt më ndryshe dhe shumë më të mëdha se problemet që i kanë gratë në Prishtinë, sepse megjithatë, ashtu sikurse edhe në gjithë Botën kryeqyteti jep më shumë mundësi dhe pavarësisht sfidave ka më shumë hapësirë për përfshirje dhe angazhim.

Problemi më i madh i grave të Kosovës lidhet me punësimin e tyre. Në Kosovë, sipas statistikave, mbi 70% të grave janë të papuna. Ato kanë mundësi, që të angazhohen në sektorët, siç janë bujqësia, ndërmarrsia, afarizmi i ndryshëm, artizanatet dhe fusha të tjera, për çka ato veç janë dëshmuar dhe punojnë, mirëpo në mungesë të një përkrahjeje institucionale shumë herë ngecin në angazhimin dhe punën e tyre dhe rrjedhimisht edhe në përfitimet që do të dalin nga kjo. Në shumë raste edhe prapa kthehen.

Unë mendoj, që ne si Kuvend duhet të japim sugjerime apo rekomandime konkrete se si të dilet nga kjo gjendje jo e lehtë, për të cilën, po them edhe një herë, s'kemi nevojë me e konstatuar se e dimë të gjithë, që është e tillë.

Është një rekomandim, në të cilin do të bazohesha. Ekzistojnë në Bashkimin Evropian të quajturat fondet strukturale, për të cilat ne asnjëherë nuk kemi folur si shoqëri. Janë mundësi, të cilat ofrojnë kredi me kamata shumë të ulëta dhe të cilat janë thithë nga vendet e rajonit. Një vend, shembull, është Kroacia, ku përmes afarizmit të grave kanë marrë donacione të shumta përmes këtyre fondeve strukturale dhe të cilat në forma të kredive të buta iu janë dhënë grave në bujqësi, grave në biznes, grave në artizanate, në mënyrë që bizneset e tyre të mund të zhvillohen.

Unë mendoj, se ky do të jetë kontributi më i madh institucional për përmirësimin e gjendjes, jo vetëm të grave në Kosovë, por në përgjithësi të qytetarëve të Kosovës.

Nuk besoj, që në këtë vend kemi nevojë të diskutojmë ndarazi, sepse ideja e punës sonë është që bashkë - burra dhe gra të punojmë në partneritet, në mënyrë që të krijojmë një vend më të mirë, ku mund të jetojnë fëmijët tanë.

Prandaj, disa nga rekomandimet, që lidhen kryesisht me përkrahjen e grave në biznes dhe në punësimin e tyre janë se Kosova ka hartuar shumë strategji, por të fillojë me zbatimin e strategjisë për gra në biznes. Unë e di që ajo ekziston e shkruar diku, por ka mbet në letër. Edhe kur është fjala për universitete, sepse vërtetë arsimimi në Kosovë është në gjendjen më të ulët të mundshme, prandaj në universitete kemi nevojë që të zhvillohen kurrikula në favor të politikave gjinore dhe ekonomike.

Pastaj, kemi nevojë të implementojmë politika ekonomike dhe fiskale, që thashë edhe më herët, për kredi me kushte më të favorshme, tatime me norma më të ulëta, si dhe ato të subvencionimit, por jo nga buxheti i Kosovës, sepse edhe kështu është shumë i varfër dhe e kuptojmë se nuk ka mundësi të bëhet kjo ndarje. Mirëpo, nga mundësitë që na jepen nga partnerët tanë, këto fonde strukturale për të cilat unë mendoj se Qeveria veç është vonuar, sepse ka mundësi që të aplikojë dhe të ecë në drejtim të thithjes së këtyre

investimeve në mënyrë që gjendja e përgjithshme në vend, që lidhet në aspektin ekonomik dhe social të grave, në rend të parë por edhe në përgjithësi e qytetarëve të Kosovës, të përmirësohet.

Unë mendoj, që një grua me një biznes të fuqishëm dhe e punësuar do të jep kontributin e saj, në rend të parë në familje, por edhe në përgjithësi në shoqëri.

Edhe një herë, ju faleminderit për përkrahjen e rekomandimeve dhe për gatishmërinë që të na përkrahni në këtë seancë.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e merr deputetja, Lirie Kajtazi!

LIRIE HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Është për tu përshëndet kjo iniciativë, që së bashku t'i nxjerrim obligimet tona apo ndoshta një vështrim në ato të cilat ne i kemi planifikuar së bashku në legjislaturat e mëparshme, por edhe kjo tani i ka aprovuar duke u nisur nga Kushtetuta, e cila na i garanton të drejtat tona, nga ligjet të cilat i kemi zbatuar vetë, nga deklaratat mijëvjeçare që ka aprovuar ky Parlament, janë krejt këto ato shtyllat mbi të cilat ne mund ta bazojmë punën për të ecur më tutje.

Do të kishim pas, ndoshta nevojë në këtë rast me i përmend disa nga shkarjet, të cilat janë bërë nga të gjitha këto apo nga planet tona të veprimit, të cilat i kemi nxjerrë edhe si detyra të përbashkëta në rajon por edhe si detyra të cilat ne vetë ia kemi shtruar veti për të ecur bashkërisht në avancimin e shoqërisë kosovare.

Në këtë drejtim, mendoj se është identifikuar problemi i shkeljes së ligjit për barazi gjinore me një udhëzim administrativ, gjë e cila s'do të duhej të ndodhte, që u është dërguar pushteteve lokale, që zyrtarët për barazi gjinore tani të mos jenë tamam, ose zyrtarët brenda zyrave, tani janë futur në njësinë e të drejtave të njeriut dhe në njëfarë forme në atë kompleksitetin e tërë të drejtave të njeriut, dhe ato sikur kanë mbetur në margjina dhe përveç që nuk kanë buxhete të ndara nuk e kanë edhe fokusin e pushteteve lokale në atë drejtim.

Do të ishte mirë, po them, të shihet kjo shkelje e Ligjit për barazi gjinore, pastaj do të kishte pas rëndësi shumë që të fokusohemi në monitorimin të cilin ia bëjmë ligjit të punës, që u përmend, me një nga avancimet që është bërë tani me zgjatjen e pushimit të lehonisë dhe nga kjo duhet të shohim sa janë cenuar gratë që të hyjnë në tregun e punës, nga se kemi mjaftë raste të paraqitura që ato me këtë zgjatje të pushimit, cenohen që në start që të futen në tregun e punës.

Po them, ka rëndësi të madhe, të shihet se ku i kemi shkelë ato ligje, të cilat ne vetë i kemi pa të domosdoshme që t'i aprovojmë për ta avancuar pozitën e gruas në përgjithësi, por edhe të shoqërisë kosovare.

Po ashtu, në trajtimin e viktimave të dhunës, edhe në familje por edhe ato të trafikimit kemi pa se nuk ka fonde të mjaftueshme apo nuk janë, mund të them, bile as gjysmake, janë veç fillestare për me e trajtua viktimën, ndërsa jo deri në fund, që ajo t'i rikthehet jetës normale. Këtë e kemi biseduar lidhur me Raportin e Këshillit për Siguri, ku është pa se ka mjaft të meta në këtë drejtim.

Unë, për fund, kisha me e kërkuar këtu para juve, dhe kisha me e adresua një letër të hapur nga gratë pensioniste apo Forumi i grave të Koalicionit të pensionisteve, që e kanë mbajtur një mbledhje ditë më parë dhe kanë kërkuar nga ne që të jemi shumë të vëmendshme në trajtimin e problemeve sociale, të cilat po ashtu kanë të bëjnë me dinjitetin, përgjithësisht të kësaj kategorie të pensionistëve, por me fokus të veçantë të grave të cilat i kanë kontribuar shoqërisë kosovare.

Prandaj, një vëmendje më e shtuar në këtë drejtim sidomos në rastet kur ne futemi në obligime me premtimet tona, i fusim në agjendë çështjet e caktuara dhe i anashkalojmë, e ky është edhe një injorim më i madh.

Dhe, krejt për fund, thash për një respekt të krejt asaj që ne e kemi miratuar gjatë punëve tona dhe që e kemi obligim njëkohësisht ndaj vetvetes për ta avancuar shoqërinë në përgjithësi dhe femrën në veçanti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonjë! Fjalën e merr, deputetja Xhevahire Izmaku!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

E nderuara ministre, dhe ju kolegë deputetë,

Kur lista me nënshkrimet tona për mbajtjen e kësaj seance mu afrua pranë, nuk isha shumë entuziaste apo nuk isha fare që Kuvendi i Republikës të mbajë një seancë të veçantë për të drejtën e femrës në vendin tonë.

Por, ishte nisma e koleges sime nga opozita dhe nuk desha ta thyej solidaritetin tradicional që e kemi ne gratë në këtë Kuvend. Jo për shkakun, që s'ka nevojë të debatohet për shumë sfida që përballet gruaja sot në vend, por për arsyen që edhe sot qasja jonë niset nga ai kënd, që me vetëdije vazhdojmë ta promovojmë, si një kuti e Pandorës, por një kuti me tjera sekrete, që qanë dhe ankohet për nënçmimin dhe përbuzjen, jo barazinë e dhunën, e ku e di se sa ankesa që duhet të kenë më pak vend këtu e shumë e shumë nisma praktike, që do të jenë shumë më frytdhënëse për gratë, për shoqërinë në përgjithësi.

Pasiviteti, pritshmëria, lutja apo përgjimi nuk na kanë sjellë as s'do të sjellin atë që e dëshirojmë dhe atë që meritojmë. Demokracia i zhdukë ose e ndryshon pabarazitë e ndryshme, të cilat i krijon shoqëria. Dhe, kjo demokraci ka nevojë për ne, gratë që tek doktrina "Klinton" jemi imperativi i kohës, jemi detyra e papërfunduar e shekullit XXI.

Të nderuar kolegë deputetë, asnjëherë më shumë se dy ditët e fundit, nuk kam parë lule më shumë në jetën time në vendin tim. Nëse për asgjë nuk shërben ky imazh, për mua që vi në politikë nga dera e kulturës dhe e artit, reflekton një fotografi të re kulturore në vendin tim.

Së paku, ky “adami i frustruar” ka filluar të kuptojë se në Kosovë gruaja po respektohet, po çmohet. Dhe ne nuk kemi nevojë sot idetë tona t’i imponojmë përmes pozicionit të viktimës. Ne jemi vlerë. Dhe, këta shokët tanë këtu në Kuvend, por edhe jashtë, na e çmojnë këtë vlerë dhe ne duhet ta pranojmë, jo ta fshehim.

Sot, ka nevojë vendi ynë për femra, të cilat me cilësi të tyre e pushtojnë hapësirën e vendimmarrjes dhe shteti për të arritur tek kjo vlerë, i ka ofruar barazi shansit. Kosova dikur, mund të konsiderohej shtet mashkullor, por jo tani.

Tani ne si shtet kemi shënuar përparime të mëdha, në aspektin e barazisë gjinore. Politika duhet pushtuar nga ne gratë për t’i humbur asaj gjuhën agresive dhe për t’i dhënë zërin e arsyes dhe në këtë drejtim ju ftoj të shohim përpara pozicionet e fuqishme femërore të shtetit tonë. Një presidente që po dërgon imazh pozitiv në botë, ministre e zëvendëskryeministre që po kryejnë një punë të mirë në përgjegjësitë e tyre. Në këtë drejtim dua të ri duartrokas kurajën publike që deputeti Sabri Hamiti e bëri publike për suksesin e ministres Çitaku. Pra duke dhënë kontribute, duke pranuar vlera, po e kthejmë vetëbesimin po bëhemi shtet i së drejtës për të gjithë.

Në këtë ekuivalencë simpatizova idenë e kolegeve të mija nga Vetëvendosja për tribunën e organizuar dhe në vështrim gratë e dhunuara gjatë luftës në vendin tonë.

Ne jemi shtet i ri, me shumë probleme të cilat u grumbulluan me dekada dhe sot vetëm një mendim jo racional e ëndërroj: që të vijë në rend çdo gjë brenda natës, por së paku të mos i nënçmojmë arritjet tona edhe në aspektin e barazisë gjinore, edhe në prezantimin e vlerave.

Finlanda e kishte një shprehje, që më pëlqeu, në dyert e Parlamentit të vetë: “Ne besojmë tek evolucioni, jo më tek revolucion”. Andaj, të besojmë se shumë sfida që prekin shoqërinë tonë, prekin paralelisht dy gjinitë, jo vetëm gruan por edhe të mirat, edhe zhvillimet po ashtu, andaj nuk pajtohem plotësisht me thirrjet e mëdha për një gjendje të rëndë të guas në Kosovë qoftë nga subjektet tona, por edhe ndërkombëtare.

Mendimi nuk ka gjini, ndaj është njerëzor që gjithë përfshinë kontributin e çdo individi pa dallim gjinie. Vlerat e krijuara në saje të punës së gjatë janë fryt i krijimtarisë të gjithë secilit, andaj ato nuk janë as mashkullore, as femërore, janë njerëzore, janë intelektuale.

Burri dhe gruaja janë qenie të ndryshme por me vlerat e njëjta për shoqërinë. Dje kishim më pak mundësi se sot. Nesër do të kemi më shumë kapacitete dhe Kosova në këtë drejtim mund të marrë epitetin e vendit shembull në rajon për të larë borxhin ndaj guas si shtyllë kurrizore e ruajtjes dhe mbijetesës së familjes, por edhe si tregues i përcaktimit tonë për të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputetja Aurora Bakalli. Atëherë, fjalën e merr Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Duke u referuar në agjendën e sotme, respektivisht në temat që po trajtohen lidhur me pozitën e gruas në shoqëri, secila nga këto tema është e rëndësishë së veçantë.

Duke u nisur nga të drejtat themelore të njeriut, fjala ime i referohet dhunës në familje. Gjatë 20-30 vjetëve të fundit, sidomos nga koha kur dhuna në familje, respektivisht dhuna në bazë gjinore u trajtua si çështje zhvillimi në mbledhjen e grave në vitin 1985 të Kombeve të Bashkuara, grupe dhe aktivistë të veçantë në tërë botën kanë ndërmarrë fushata të fuqishme kundër abuzimeve të tilla. Dhe ne sot, me rastin e shënimit të 8 Marsit, po e bëjmë një gjë të tillë. Por, a mjafton që njëherë në vit të ndërmerret diçka e tillë? Unë mendoj që jo!

Këto çështje duhet trajtohen në mënyrë graduale dhe në mënyrë kontinuele, duke e ditur se dhuna në familje është pjesë e përditshme e shumë grave, është pjesë përbërëse e dinamikës së shumë situatave familjare, ku zakonisht viktimë është gruaja. Pra, thelbësore është ideja e pabarazisë sado që dokumentet ligjore për barazi gjinore më shumë i gjejmë në letër.

Në këtë seancë të veçantë, por edhe tërë fushatat dhe aktivitetet e tilla do të dëshiroja që këto tema të trajtohen dhe iniciohen edhe nga burrat dhe sot, deri diku, po bëhet një gjë e tillë. Duke pasur për qëllim zvogëlimin e dhunës kundër gruas, sepse eliminimi i tërësishëm është i pamundur, në këto programe duhet të kenë synim burrat, sepse ata duhen të ndryshojnë. Po ashtu, duhet të sigurohemi se trajtimi i rasteve të tilla në organet përgjegjëse, si: policia e tjera, të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të trajtohen me dinjitet e jo të trajtohen si raste normale të incidenteve tona apo të injorohen, siç janë raportuar raste të tilla.

Përveç kësaj Qeveria duhet të ketë parasysh se këto viktima përveç mbrojtjes ligjore kanë nevojë edhe për mirëqenie sociale. Andaj, ndërtimi i strehimoreve të veçanta është i domosdoshëm. Nuk mjaftojnë një apo dy strehimore dhe nuk mjafton strehimi i viktimave për dy apo tri javë. Duhet ndarë fonde të veçanta për qendra të tilla.

Për të mos e zgjatur më shumë, e drejta për të qenë i lirë nga dhuna në familje është e drejtë njerëzore, universale. Andaj, mesazhi im është: që të përdoren tërë mekanizmat që kjo e drejtë të jetësohet ngase gruaja meriton më shumë se kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara ministre,

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju kolege të nderuara,
Më vjen mirë që sot edhe në shenjë simbolike me rastin e 8 marsit është organizuar kjo seancë parlamentare, andaj shpresoj dhe mendoj ashtu që duhet të shërbejë si apel për të gjithë ata të cilët janë pjesë e vendimmarrjes. Duhet të shërbejë edhe si apel vetëdijësues mbarë shoqëror.

Fjalët e mia sot janë një tribu për të gjitha femrat e vendit tim, të cilat edhe pse të mbërthyera në një shoqëri patriarkale, me doke e zakone të stërvjetëruara, femra shqiptare u gjend në vazhdimësi pa u kursyer përballë sfidave të rënda të kohës. Trajtimi ligjor i saj ishte jo njerëzor. Atyre iu kontestuan të drejtat themelore, u privuan nga arsimimi edhe pse ishin ato mbi supet e të cilave rënkonte dhe rëndonte edukimi i brezave të ri.

Femrat shqiptare me dekada e shekuj ishin të dënuara të kalojnë jetën në një rreth të ngushtë social duke e vuajtur si pasojë një botëkuptim të kufizuar, por me gjithë vështirësitë me të cilat u përballën, femrat shqiptare dëshmuuan se janë të afta të marrin forcën dhe guximin për të shtruar ndikimin e tyre në të gjitha sferat e jetës. Ato arritën të kyçen në institute arsimore, në shoqata dhe aktivitete kombëtare, në organizimin dhe ndërtimin e shtetit:

Teuta, mbretëreshë dardane; Nora Kelmendi, heroinë; Laskarina Pinoqe Bubulina, heroinë dhe kapitene e Fregatës; Tringa Smajla, luftëtare; Shotë Galica, luftëtare; Sala Jashari; Xhevë Lladrovci; Fatime Hetemi, e shumë luftëtare tjera të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; Elena Lukrecia Peskopia, femra e parë në botë me titullin “Doktore e filozofisë”, Eleni Bukura, piktoe - femra e parë në botë që arriti të futej në atelienë e burrave në Akademinë e Arteve të Romës dhe Napolit; Elena Gjika, shkencëtare, shkrimtare, publiciste, diplomate, enciklopediste, njëra ndër gratë më të njohura në Evropën e shekullit XIX; Kushe Mica, themeluese e shkollës së parë shqipe për femra; Motrat Qiriazhi, intelektuale dhe atdhetare, Nëna Terezë, humaniste, fituese e çmimit Nobel për paqe.

Këta janë vetëm pak emra, të cilët buqasin thekshëm në ndërgjegjen tonë për gjithë kontributin, dhembjen dhe dinjitetin e femrës shqiptare. Janë vetëm disa shembuj të forcës së pashterur që buron nga shpirti i tyre.

Femrat shqiptare gjatë gjithë historisë kanë marrë rolin më të rëndë në ruajtjen e familjes, me edukimin e brezave dhe me mbështetjen e proceseve shoqërore, kombëtare e deri në vetëflirimin. Ato përherë e vërtetuan se janë boshti i familjes dhe i shoqërisë.

Edhe në historinë tonë më të re, kontributi i femrës ishte një nga aspektet më të dhimbshme dhe më të dinjitetshme. Ato ishin në shumë fronte. Prandaj me këtë rast dua të përkulem para të gjithë atyre që bënë luftë shumë fronteshe, e këto janë: nënat, motrat, gratë dhe bijat e Kosovës. Kur burrat iu ngjiten maleve mbi supet e grave ra barra më e vështirë e jetës. Mbi supet e tyre ato bartën vuajtjen dhe përgjegjësinë për të përkrahur pa kompensim vendimet e familjarëve të tyre për rezistencë, për të edukuar breza të tërë në frymën e atdhe dashurisë, për të kontribuar pa u kursyer deri në vetëmohim. Dua që të

shpreh një falënderim për të gjithë ato motrat, bijat e nusët e vendit tonë, munda i të cilave ishte dhe vazhdon të mbetet inspirim për ne.

Me këtë rast edhe një falënderim dhe respekt të veçantë e meritojnë gratë e familjes së komandantit legjendar Adem Jashari, të cilat që 13 vjet me dinjitet po e mbajnë këtë emër. Jeni shembull se si femra jonë në vend të frikës, zhgënjimit, dështimit e lodhjes ajo rritet me detyrat që i parashtrohen në jetë. E njëjta vlen edhe për gratë e Krushës, peripecitë e të cilave për mbijetesë nuk gjetën dhe nuk gjejnë gjithmonë mirëkuptim në shoqërinë tonë. E njëjta vlen edhe për të gjitha ato nëna, të cilat çdo ditë jetojnë duke e sfiduar dhembjen për humbjen e fëmijëve që i sollën vetë në jetë e që nga kriminelët iu rrëmbyen nga dora për t'i çnjerëzuar, vranë e masakruar, siç dua në këtë rast ta përmend rastin e Shpresës 18 vjeçare. Dhembja e tyre nuk mund të matet, aq sa mund të matet edhe vetë gjithësia.

Sot pas 13 vjet nga përfundimi i luftës, është shqetësuese se sa pak po bëhet për përmirësimin e pozitës së gruas në këtë shoqëri. Dikush duke parë pjesëmarrjen tonë këtu, do të thotë kjo nuk përkon me të vërtetën. Por unë ju them: ku do të ishim ne po qe mos të ekzistonte kuota gjinore e cila është obligative.

Jam shumë e bindur se në këtë rast femrat pjesëmarrëse këtu në Kuvend do të mund t'i numëroje me gishtat e dorës. Ende mungojnë politika konkrete, të cilat kontribuojnë konkretisht në përmirësimin e pozitës së femrës, të cilat përbëjnë mbi 50% të popullatës në Kosovës.

Ligjet sado që në letër janë konform standardeve më të larta evropiane për mbrojtjen e femrave nga abuzimet çfarëdo qofshin ato, nuk janë duke u zbatuar si duhet.

Pozita e femrës në shoqëri tonë vazhdon të mbetet ende një vrimë e zezë. Trajtimi i kësaj çështje vazhdon të bëhet vetëm sa për sy e faqe dhe kjo nuk është e tolerueshme. Sepse, të nderuara zonja dhe zotërinj, kontributi i femrës shqiptare nuk është fenomen modern, nuk është as fenomen i motivuar nga ndjenja për përfitime çfarëdo lloji qofshin ato, sepse ai nuk njihet oportunitizëm.

Kontributi i femrave shqiptare buron nga shpirti njerëzor, nga forca dhe mençuria e tyre. Ne duhet me këmbëngulje të kërkojmë dhe të japim kontribut edhe më të madh që femra mos të trajtohet si objekt, por si subjekt esencial për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë tonë. Pasardhëset e Teutës, Norë Kelmendit, Bubulinës, Shotë Galicës, Xhevë Lladrovci, Elena Gjikës dhe Nënë Terezës nuk kërkojnë lëmoshe, por nuk pranojnë të trajtohen si përmbushje e kuotës obligative dhe të dënohen me heshtje dhe anashkalime. Pasardhëset e këtyre margaritarëve, ikonave historike shqiptare - kërkojnë punë dhe llogaridhënie, kërkojnë zell dhe përgjegjësi, kërkojnë respekt. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Është për të ardhur keq që kabineti qeveritar nuk është i pranishëm në këtë debat. Kjo tregon se Qeveria nuk i kushton rëndësi e as seriozitet kësaj çështje, kur dimë që ata janë ekzekutivi që do t'i zbatojnë rekomandimet që dalin nga ky Kuvend.

Fillimisht, problemi i grave nuk zgjidhet duke kërkuar një grua më shumë në ndonjë organ, kryesi, komision, apo kudo tjetër. Pra, s'ka fare të bëjë me kuantitetin.

Problemet e gruas duhet të merren shumë seriozisht e që nevojitet angazhim i plotë i të gjitha institucioneve, nevojitet angazhim i plotë shoqëror.

Shumë shpesh ne merremi me çështjet e grave, por fokusin e vendosim te gratë në qytet ose te gratë në politikë, ndërkohë që nuk e ndajmë situatën në mes qytetit e fshatit. Dhe çështjet e grave në fshat mbeten të paditura ose më saktë - nuk e kuptojmë se sa vuajnë ato dhe se sa e vështirë është gjendja e tyre.

Gratë në zonat rurale vuajnë nga varfëria, puna e tepërt, problemet e shëndetit e sidomos anemia, dhe jo vetëm kaq. De fakto ato nuk e gëzojnë të drejtën e votës, por kemi shumë shembuj nga vëzhguesit tanë në zgjedhjet e fundit ku gratë nuk janë lënë të hynë vetë në kutit e votimit dhe duke iu imponuar votimi pa të drejtë nga burrat e tyre. Në lidhje me këtë kemi pasur edhe shqetësimin e shumë raporteve vendore dhe ndërkombëtare.

Më pastaj, çështja e edukimit të grave dhe vajzave në zonat rurale, vazhdon të mbetet shumë problem, sepse ka një pabarazi të dukshme midis edukimit të djemve dhe vajzave, sidomos në edukimin e mesëm e mos të flasim për atë universitar. Shumë shpesh gratë apo femrat nuk e vijnë as shkollimin e mesëm për shkak se shkollat gjenden shumë larg dhe vajzat adoleshente nuk lejohen të vijnë mësimin qoftë për shkaqe sigurie, qoftë të mentalitetit.

Problem tjetër që prek gratë dhe femrat në zonat rurale është edhe mohimi i të drejtës për të vendosur lirshëm për jetën e saj, imponimi i martesave të hershme nga familja kundër vullnetit të tyre. Gjithashtu, problem shumë shqetësues mbetet edhe mohimi i të drejtës së fjalës dhe kjo jo vetëm brenda familjes, por edhe në rrethet shoqërore. Bile ende gratë rrinë të ndara në dhomat e veçanta nga burrat. Gjithashtu, mohimi i të drejtës për tu angazhuar politikisht në jetën publike për vajzat e gratë në zonat rurale është gati i pamundur që të jenë aktive. Pra, me pa të drejtë rrethi shoqëror, familjar i detyron ato që merren vetëm me sferën private apo vetëm me punët e shtëpisë.

Në bazë të statistikave, gratë e zonave rurale po llogariten 25 deri 30% e gjithë popullsisë së vendit dhe e gjithë kjo përqindje sjell deri te një shqetësim që këto gra janë të pa përfaqësuara dhe të pa pranishme. Me një fjalë janë lënë në mëshirë të fatit, pra janë lënë t'i zgjidhin hallet me njëra-tjetrën ose me të ardhurat që i vijnë nga emigracioni. Po ashtu, janë të painformuara. Janë të painformuara për të drejtat e tyre mbi ligjet që ekzistojnë dhe këto institucione asnjëherë nuk e kanë marrë ndonjë iniciativë në lidhje me këtë. Gratë dhe vajzat në zonat rurale vuajnë shumë më tepër për mungesën e shtetit dhe politikave sociale, sepse tendenca e shtetit siç po shihet është që këto zona t'i lërë t'ia dalin vetë.

Detyra e një shtetit të mirëfilltë është të ofrojë politika sociale ku të gjithë të kenë mundësitë për edukim, punësim, shërbime sociale e shëndetësore. Nuk arrihet pjesëmarrja me vetëm me një kategori të shoqërisë, pra kur gratë dhe vajzat janë të përjashtuara bile edhe të harruara nga institucionet.

Mos përfaqësimi i një pjese të shoqërisë nuk përkon me standardet demokratike, pra nuk mund të flasim për një rend demokratik për sa kohë një pjesë e shoqërisë nuk do të angazhohet në sferën publike e veçanërisht në atë politike.

Lëvizja Vetëvendosje dhe Grupi Parlamentar mendon se pa emancipimin e grave dhe vajzave nuk do të jetë e mundur të mbërrijmë emancipimin e shoqërisë si të tërë.

Gjithashtu, për fund dua të shtoj se këtu, por jo vetëm këtu, numërohen emrat e veprimtareve, artisteve, studiuesve dhe luftëtarëve. Për mendimin tim, kjo është veçse një hipokrizi, sepse nuk mund të kalohet kjo me një listim të emrave dhe elozhe ceremoniale.

E vërteta është se shumë prej jush, por edhe të tjerë që nuk janë këtu nuk e kanë sa shqetësimin më të vogël në lidhje me këtë. Nuk kemi nevojë të shohim aktrim emocional dhe fjalim prekës. Ekzekutivi ka mundësi që të bëjë ndryshime dhe të marr iniciativa konkrete. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonjë a zonjushë! Fjalën e merr Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Faleminderit, kryesues!

I nderuari, kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar, që jeni mbet vetëm dy,

Të nderuar deputetë,

Shoqëria jonë po kalon nëpër një periudhë vërtetë të vështirë. Dikush madje me peshë u ngrit para pak kohësh dhe pa asnjë hezitim e tha troç: se shoqëria kosovare është e sëmurë. Konstatime të tjera të llojllojshme e fatkeqësisht negative dëgjojmë përditë nga njohësit e shoqërisë dhe marrëdhënieve shoqërore.

Nuk dua ta prish ditën me shprehjet, konstatimet dhe pagëzimet që fatkeqësisht i dëgjojmë përditë dhe janë tmerrësisht të vërteta.

Nuk dua të keqpërdorë kohën dhe t'ua rikujtoj ato, por dua t'ua rikujtoj diçka që i mungon dhe i duhet shoqërisë sonë, vërtetë dhe fatkeqësisht të sëmurë. Më shumë se kurrë kujtoj se na mungon dashuria dhe solidariteti dhe më shumë se cilado ditë tjetër këto dy virtyte t'i kujton 8 marsi - Dita e Grave apo siç na pëlqen një shumicë ta quajmë "Dita e nënave". Kush fal më shumë dashuri, mirësi, dhembshuri dhe ndjenja se sa nëna, gruaja, motra apo vajza? Shoqëria jonë ka kaluar një tronditje të madhe dhe me pasoja që mund të zbuten vetëm me dashurinë amnore, solidaritetin dhe butësinë e nënës, motrës, gruas, vajzës. Nëse shoqëria jonë është e sëmurë, asgjë nuk e shëron më mirë se kultivimi i dashurisë amnore, asgjë nuk e ushqen më mirë se sa butësia.

Para shumë kohësh, Ipseni kishte thënë: “gruaja nuk mund të jetë vetja e saj në shoqërinë e sotme, e cila është një shoqëri ekskluzivisht mashkullore me ligjet e krijuara nga burrat dhe sistemin gjyqësor që gjykon sjelljen femërore prej pikëpamjes mashkullore”. Prandaj, është i kuptueshëm edhe pretendimi i Virxhinia Volltis se shumica e autorit të njohur si: Anonimus apo i panjohur doli të ketë qenë femra.

Fatkeqësisht, përkundër disa hapave të bëra në drejtim të ndryshimit të këtyre raporteve dhe pozicioneve shoqërore, femra vazhdon të mbetet e marginalizuar në shoqërinë tonë. Është e vërtetë se ata që nuk i njohin mirë rrethanat kosovare, mund të kontestojnë qëndrime të tilla duke na e përkujtuar presidenten tonë, zëvendëskryeministren apo ministren e ndonjë emër tjetër që megjithatë kanë arritur të mbijetojnë shumicën mashkullore të pushtetit. Por, ata që i njohin më mirë rrethanat kosovare, kontekstin kulturor kosovar dhe shoqërinë tonë në momentin nëpër të cilën po kalon nuk besoj se do të kontestojë në marginalizimin e femrës në shoqërinë tonë. Unë ruaj një bindje të veçantë mbase se shoqëria jonë, si shoqëri e traumatizuar nga lufta apo si shoqëri e sëmurë nga tranzicioni siç e quajti dikush jo fort moti, ka nevojë për thellësinë e të menduarit femëror, dashurinë dhe solidaritetin amnor më tepër se për bukë e ujë.

Po e shfrytëzojmë këtë datë dhe festë për të përkujtuar se dashuria amnore, ndjesia dhe solidariteti femëror në qasje ndaj problemeve dhe fërkimeve, thellësia e rezonit femëror në zgjidhjen e mospajtimeve dhe përplasjeve janë bari më i mirë për shoqërinë të sëmurë. E, kush më mirë se sa dora nënës largon dhembjen në sëmundje dhe qetëson gjakrat nga përplasjet dhe frustrimet e ndërsjella dhe të përditshme.

Prandaj, të kujtojmë në këtë ditë edhe nevojën për tu falur atyre kujdes dhe dashuri, në mënyrë të veçantë nënave tona.

Këtë fjalë timen të shkurtër do të doja ta mbyll me një thënie tjetër të urtë nga Briga Miang që thotë: “Duke e edukuar një mashkull, ju edukoni një mashkull. Duke e edukuar një grua ju edukoni një gjeneratë”.

Prandaj, le të jetë 8 Marsi jo një ditë e nënave dhe grave që përmbillet me një tufë lule apo me një koktej, por një ditë për të kujtuar obligimin shoqëror, për t’ju përkushtuar edukimit, ngritjes dhe fuqizimit të rolit të femrës në shoqërinë kosovare 365 ditë të vitit. Le të shërbejë për të rikujtuar nevojat e tare për strehim dhe siguri sociale dhe ekonomike, për arsimim dhe edukim bashkëkohor, dhe pa asnjë lloj diskriminimi, për shërbimet e sigurimit shëndetësorë gjithëpërfshirëse për vete dhe fëmijët e tyre, për sigurime pensionale që u garantojnë jetë të dinjitetshme edhe pas pensionimit. Për të gjitha këto le të ndjehemi pak më shumë përgjegjës, sepse vetëm në këtë mënyrë i japim kuptim kreutimit të ditëve të tilla.

Ndryshe, kjo mbetet vetëm dhurim i luleve pa erë, hipokrizi dhe improvizim i kujdesit dhe mirësjelljes, i borxhit dhe nderit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër, ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Falënderoj Grupin e grave deputete për këtë debat parlamentar lidhur me Ditën Ndërkombëtare të Gruas dhe më lejoni që të jap kontribut në këtë debat.

Gruaja në të kaluarën ishte në kërkim të pozitës së saj, deri sa ajo ishte nëpërkëmbur, dinjiteti i saj ishte i shtypur. Pra, në të gjitha fushat ajo ishte në pamundësi për të vendosur për të drejtat e saj. Njerëzit në botë duhet të tregojnë solidaritetin e tyre me gratë e guximshme, të cilat po luajnë një rol qenësor në mbështetje për respektimin e drejtave të grave, konkretisht të femrave.

Kjo ditë simbolikisht i dedikohet mbi të gjitha grave të thjeshta, të cilat në saje të vlerave të tyre ndryshuan historinë botërore. Kjo ditë u kushtohet grave, të cilat për shekuj luftuan për barazinë e gruas në shoqëri. Mesazhi që dërgohet në këtë ditë duhet të jetë për çdo ditë, për çdo vit, e sa të jetojë njeriu.

Femra dhe mashkulli janë krijesa të zotit dhe në asnjë mënyrë nuk është e një rangu më të ulët se mashkulli. Duhet garantuar çdo anëtar i shoqërisë të drejtat dhe barazinë në mes tyre, duke e pasur zbatueshmëri të drejtave pa dallim.

Në shoqërinë kosovare ende nuk është arritur e drejta totale e femrës, por kur flasim për të drejtën totale të gjinisë femërore duhet të kemi parasysh së pari edukimin dhe shkollimin e pastaj lirinë totale të pavarur, personale dhe individuale.

Jo rastësisht thuhet se femra është gjysma e shoqërisë. Një femër punëtore si produkt ka një fëmijë punëtor, një femër e arsimuar produkt ka familjen dhe shoqërinë e arsimuar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në këtë debat mbi të drejtën e femrës nuk mund të kaloj pa i përmendur të drejtat e femrës, të cilat po privohen në praktikë në Kosovë. Duhet të kemi parasysh të drejtën e saj për shkollim e punësim e që fatkeqësisht në Kosovë po kemi probleme në këtë drejtim. Sot nuk lejohen të vijojnë mësimin femrat për shkak të shfaqjes publike të bindjes fetare. Kushtetuta dhe ligjet në përgjithësi lejojnë, por udhëzimet administrative të niveleve më të ulëta po i ndalojnë.

Unë po ju pyes juve se cili nga ju pranon që vajza e tij, për shkak të manifestimit të bindjes fetare, lejon të mos shkollohet?

Veshja paraqet personalitetin e individit, karakterin e tij, andaj çështja e shamisë së kokës është krejtësisht një çështje e drejtave të njeriut, e drejtave të femrës: e bën, e bart ose s'e bart. Qëllimi i fundit i të gjitha të drejtave të njeriut është zhvillimi i plotë dhe i lirë i çdo personaliteti në kushtet e barazisë. E, në bazë të kësaj shoqëria civile duhet të jetë e hapur dhe t'i integrojë të gjithë personat, duke përfshirë edhe pakicat kombëtare dhe personat me aftësi të kufizuara, e të mos flasim për femrat. Çdo njeri e gëzon të drejtën e arsimimit dhe prapë edhe këtu nuk do të duhej të bëhet fjalë për të drejtat e

vajzave për shkollim, ngase kjo do të reflektonte një çështje tjetër dhe do të sillte deri te diskutimi i shekullit të kaluar se femra a është njeri apo jo.

Prandaj, arsimimi për një femër do të thotë të ketë mundësi të mësojë më shumë, të zhvillojë aftësi dhe talent, të bëjë dhe mbajë miq, të ketë më shumë besim në vetvete, të shmang përfshirjen në krime, të ketë një zgjidhje më të madhe për punë kur të vijë koha, të mos jetë barrë e shoqërisë por promotor i ndryshimeve pozitive në shoqëri.

Është shumë absurd e vandalizëm që njerëzit e ndryshëm të marrin kompetenca dhe guxim dhe ua mohojnë arsimimin dhe punësimin këtyre vajzave.

Përderisa vendet tjera preokupohen me problemin e mosshkollimit dhe braktisjes së shkollës, tek ne i ndalojmë nxënësit nga shkolla.

Përderisa, vendet tjera bëjnë politika për t'i rikthyer në shkolla ata që e braktisin atë, tek ne pushtetarët nxjerrin udhëzime administrative dhe i largojnë nxënësit nga shkolla, ndërsa në anën tjetër shpenzohet nga buxheti i Kosovës për planet dhe strategji të ndryshme në përpjekje që të krijohen kushte për gjithëpërfshirjen e fëmijëve në arsimin e obligueshëm.

Kurse, në aspektin e zhvillimit dhe shtet ndërtimit të themi se në vend që të fusni në shkollë një të re, ju po e largoni nga shkolla, në vend që të krijoni një punëtoare ju po krijoni parazit, në vend që të krijoni intelektuale ju po krijoni amvise, në vend që të krijoni edukatore të fëmijëve po krijoni pastruese, në vend që të krijoni konkurrente të tregut botëror po shtoni barrë për buxhetin e shtetit.

Në këtë moment u bëj thirrje të gjithë zyrtarëve kompetentë: Që t'i lënë anash bindjet personale dhe të dalin jashtë vetes, e t'i bëjnë veprimet e tyre konkrete e korrekte, ta zbatojnë ligjin në përpikëri, të kemi njohje dhe kultivimin e diversitetit si vlerë universale, vlerë e popullit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Para se të vazhdojmë, kolegë të nderuar, unë ju njoftoj se janë të paraqitur për të folur edhe tetë vetë.

Unë mendoj që s'duhet të japim pauzë, sepse është dita e fundit dhe është mirë ta kryejmë punën.

Në ndërkohë mundet paraqitësja e përfundimeve t'i merr koleget, me të cilët mendon t'i ribëjë ose t'i redaktojë dhe të kthehet deri sa ne ta vazhdojmë diskutimin. Faleminderit! Fjalën e ka Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E nderuar ministre Çitaku,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke u nisur nga romakët e vjetër, ku gruaja ishte e varur nga burri dominues, i zoti i shtëpisë, dhe nuk merrte pjesë në jetën publike, por kishte një rëndësi të veçantë rreth

shtëpisë e të gjitha gjërave që i përkasin asaj, ajo quhej “domina” - e zonja e shtëpisë, e deri më sot, të drejtat e gruas janë avancuar në një masë të madhe.

Principi i barazisë gjinore është njohur qysh në themelimin e Kombeve të Bashkuara në vitin 1946, principi i barazisë gjinore dhe Deklarata e përgjithshme e të drejtave të njeriut e vitit 1948 e bëjnë themelin e mosdiskriminimit në bazën gjinore. Po ashtu, edhe në Konventën e Gjenevës të vitit 1948, për herë të parë, theksohet e drejta për mbrojtjen e gruas nga dhunimi, prostitucioni i detyruar dhe atakimet e tjera jo të ndershme dhe në gjendje lufte. Në dhjetor të vitit 1979, në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, të mbajtur në Nju-Jork, aprovohet Marrëveshja për eliminimin e diskriminimit të gruas në çdo formë.

Deri më tani janë organizuar 4 konferenca botërore për të drejtat e gruas: në vitin 1975 Konferenca e parë botërore e gruas në Meksikë; në vitin 1980 Konferenca e dytë botërore e gruas në Kopenhagë; më 1985 Konferenca e tretë botërore e gruas në Najrobi; më 1995 Konferenca IV botërore e gruas në Pekin.

Gruaja merr pjesë në zgjedhje për herë të parë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe atë më 6 shtator të vitit 1870.

Forumi botëror ekonomik për barazi ka bërë krahasimin e shteteve në bazë të pozitës së gruas. Ekspertët e këtij forumi raportin e tyre e përpiluan në bazë të analizave të shumta statistikore dhe në rend të parë në bazë të pozitës së gruas në politikë, ekonomi, arsim dhe sistemin shëndetësor. Nga këto lëmi analizohen të dhënat nga gjithsej 14 sfera, dhe në rend të parë të ardhurat personale për punën e njëjtë, kualifikimi shkollor dhe universitar, kuota mesatare e pjesëmarrjes së gruas në pozitën udhëheqëse të ndërmarrjeve dhe pozitat e larta politike.

Në bazë të këtyre analizave, kemi renditjen e shteteve në vitin 2010 ku e para në këtë vend është Islanda, e pastaj Norvegjia, Finlanda, Suedia.

Vetëm sa për njoftim, në fundin e kësaj liste gjenden Pakistani, Çadi dhe Jemeni.

Po ashtu, Komisioni Evropian pretendon që pjesëmarrja e gruas në këshillat udhëheqëse deri në vitin 2020 të arrijnë kuotën 40% dhe kjo e përcaktuar me anë të ligjit. Në bazë të dhënave në nivelin botëror 62% e vendeve të punës janë meshkuj dhe 38% janë femra. 90% të ulëseve në parlamente e përbëjnë meshkujt, ndërsa 10% femra. Postet qeveritare 94% meshkuj, ndërsa 6% femra. Në bazë të këtyre të dhënave, shihet se bota është e ndarë në mënyrë të padrejtë.

Sa i përket Kosovës, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, është pjesë e dokumentit të presidentit të Ahtisari dhe është pjesë e Kushtetutës së Kosovës.

Ne e kemi kuotën 30% e cila, sipas meje, është e domosdoshme duke pasur parasysh historikun pak a shumë patriarkal të shoqërisë kosovare. Kjo e mundëson kontributin më

të madh dhe më aktiv të gruas kosovare në të gjitha rrjedhat politike, ekonomike, kulturore, sociale, e tjera.

Ne i kemi pozitat e ministreve në Qeverinë kosovare të udhëhequra në mënyrë shumë të suksesshme nga gratë. Ne kemi edhe presidenten e Kosovës, prandaj mendoj se ky trend duhet të vazhdojë edhe më tutje.

Në këtë mënyrë shfrytëzohet potenciali gjenetik i çdo populli, i cili sipas rregullave biologjike, është 50% meshkuj dhe 50% femra.

Dhe, në fund të fjalimin tim dua ta përfundoj me një thënie të një shkrimtareje të njohur amerikane ku thotë: “ Të gjithë meshkujt janë të fortë, por të gjithë meshkujt lindin nga gratë”. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Deputetja Vjosë Osmani e ka fjalën!

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

E nderuara ministre,

Në fakt, në fund të këtij përfundimi ashtu siç u tha edhe nga disa deputetë sot, unë do të shpresoja që së paku ministrja si përfaqësuese e Qeverisë sot në këtë seancë do të mbështesë rekomandimet që dalin nga Grupi i Deputeteve, sepse mendoj që kjo do të jepte një përkrahje më të madhe institucionale kësaj iniciative të Grupit të grave deputete dhe ne do t'i ishim falënderuese nëse një gjë e tillë ndodh.

Unë do të preki shumë shkurtë një çështje, e cila nuk u diskutua dhe kjo ka të bëjë me gratë në diplomaci.

Aktualisht, Kosova përfaqësohet nga një trupë diplomatike që nga 18 ambasadorë vetëm 2 janë gra ambasadore dhe një numër shumë i vogël është edhe në trupat apo pozitat diplomatike.

Pra, edhe në këtë rast si në shumicën e fushave të tjera, kjo situatë nuk u krijua nga mungesa e dispozitave kushtetuese ligjore, por pikërisht nga injorimi i tyre. Prandaj, ajo që po kërkojmë ne sot nuk është vajtim, siç u tha më herët. Është trajtimi me ligj i çështjeve që nuk janë të trajtuara me ligj dhe zbatimi i ligjit për çështjet që tashmë janë të trajtuara në ligje konkrete.

Çështja e grave në diplomaci tashmë është shumë qartë e trajtuar në Kushtetutën e Kosovës, në Ligjin për barazi gjinore dhe në Konventën ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas. Pra, shumë qartë, është e paraqitur në veçanti në nenin 3.4. të Ligjit për barazi gjinore ku kërkohet barazi e plotë e emërimeve jashtë vendit, pra për të gjitha pozitat në diplomaci.

Fatkeqësisht, para disa ditësh numri 2 i diplomacisë kosovare deklaroi se “Gratë nuk qenkan për diplomaci, sepse diplomacia është sikurse ushtria një profesion sipas të cilit gratë nuk mund ta kryejnë për shkak të pozitës së tyre specifike”.

Në fakt, në qoftë se një gjë e tillë është e saktë, atëherë fjalimet e shumta që u dëgjuan sot nga deputeti Krasniqi, nga deputetja Musliu dhe deputetë të shumtë - do të ishin të pakuptimta, sepse gratë jo vetëm që kanë dëshmuar që janë për ushtri, e kanë dëshmuar këtë me sakrificat e tyre. Pra, gratë jo vetëm që janë për ushtri, por janë edhe për diplomaci, por një deklaram i tillë i numrit 2 të diplomacisë kosovare është shumë dekurajues, është shumë fyes dhe është shumë cinik, mbi të gjitha, dhe tregon qëndrimin që për momentin ka diplomacia kosovare e cila u konkretizua përmes listës njëgjjinore të propozuar nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Dikush prej jush mund të thotë që kjo u përmirësua, por problemi është që përmirësimi u bë vetëm pas reagimit të Grupit të grave deputete, të cilat, natyrisht u thirrën në dispozitat ligjore dhe kushtetuese në fuqi dhe ministri i Punëve të Jashtme vetë pastaj e pranon përmes letrës së dërguar Grupit të grave deputete se “shkelja paska ndodhur dhe do ta përmirësojnë atë”.

Pra, problemi ekziston këtu që për respektim të ligjit, ne duhet të reagojmë dhe të kërkojmë nga institucionet qeveritare që të ndodh një diçka e tillë, për derisa ato do të duhej ta bënin këtë pa reagimin tonë, pa insistencën tonë dhe pa kërkesat e Grupit të grave deputete.

Unë mendoj që një qasje e tillë duhet të ndalet. Gratë në diplomaci, duke filluar nga presidentja, si shefe e politikës së jashtme, po e jap një shembull të mirë, që u përmend Nëna Terezë, por natyrisht edhe shumë meshkuj, se Presidenti Rugova dhe të tjerë e kanë sjell Kosovën në hartën botërore dhe e kanë bërë një prej çështjeve më të rëndësishme diplomatike, por kjo qasje e përbashkët, pra e punës së përbashkët të femrave dhe meshkujve - mund të arrihet vetëm në qoftë se nuk mendojmë në mënyrë kaq fyese, se femrat nuk qenkan për diplomaci dhe kjo vjen pikërisht nga udhëheqësit e diplomacisë së tanishme.

Kjo është konkretizuar jo vetëm me listën e propozuar me ambasadorë, por edhe me largimin e dy femrave në Ministrinë e Punëve të Jashtme nga pozita menaxhuese, të cilat kanë qenë drejtore dhe themeluese të atyre departamenteve në momentin kur Ministria e Punëve të Jashtme ka filluar së punuari.

Unë bëj thirrje edhe njëherë këtu, dhe natyrisht shpresoj që ta kem përkrahjen e deputetëve në përgjithësi, pavarësisht gjinisë, sepse ky është një konkretizim apo një veprim i përbashkët - përfaqësimi i Kosovës ndërkombëtarisht është në interes të gjithë neve dhe një gjë të tillë mendoj që mund ta bëjë po aq mirë edhe gruaja, ashtu siç e bëjnë edhe burrat e shumtë që i kemi sot në diplomaci.

Prandaj, unë shpresoj që qasja të ndryshojë dhe të arrihet barazia, ashtu siç e kërkon neni 3.4. i Ligjit për barazi gjinore. Pra, këtu s'kemi çka të shpikim, Ligji ekziston, krejt çka kërkohet është zbatim i tij.

Çështja e dytë, që shumë shpejtë dua ta trajtojë është çështja e qasjes në drejtësi.

U përmend sot këtu dhunimi femrave të shumta, i mijëra femrave në Kosovë dhe problemi në Kosovë qëndron që ato nuk kanë pasur qasje as në drejtësi të gjykatave, por as në drejtësinë morale.

Unë do të them këtu se drejtësia ndaj këtyre femrave është në fakt drejtësi ndaj Kosovës. Prandaj shoqëria duhet ta ketë një qasje krejt të re e tjetër ndaj tyre, sepse edhe ato që janë rrëfyer, që ka qenë ju e dini në një shoqëri të Kosovës me një vështirësi jashtëzakonisht të madhe për to, kanë hasur në reperkusione apo dënime morale brenda shoqërisë dhe tani ato kanë vështirësi që ta tregojnë rrëfimin e tyre për së dyti herë kur kërkohet si provë në Gjykatën Ndërkombëtare apo Tribunalin Ndërkombëtar për krimet në ish-Jugosllavi.

Mos harroni që jo vetëm sa i përket krimeve në Kosovë, por edhe krimet në Bosnje edhe në Ruandë edhe në vendet e tjera - elementi i dhunimit të femrës së një grupi të caktuar etnik është element i krimit të gjenocidit. Prandaj ne duhet të kërkojmë drejtësi, sepse me një gjë të tillë do të dëshmohej kryerja e gjenocidit në Kosovë, për të cilin shumë shtete edhe po i qesin dyshimet e tyre.

Përfundimisht, ajo që e tha edhe kryetari i Kuvendit, unë besoj se qëndron shumë, sepse ajo që ne po e kërkojmë për gruan nuk është një garë. Ajo që ne po e kërkojmë për gruan sot është në të mirë të shoqërisë. Ajo që ne po e kërkojmë është pikërisht që të kemi më shumë kryevepra si: "Baresha", më shumë Majlinda Kelmendi dhe më shumë vepra të tjera teatrale dhe në fushat tjera. Dhe, këtë mund ta arrijmë vetëm me barazi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Aurora Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Për deri sa sot është vendosur që të mbahet një seancë parlamentare për gruan dhe rolin e saj, nuk do mend se pozita e gruas në shoqërinë tonë nuk e ka arritur ende nivelin e dëshiruara.

Grupi i grave deputete i kishte përmendur disa tema për këtë seancë, ndërsa mua më sfidoj tema që kishte të bënte me gruan në shkencë, temë kjo e cila shumë pak u prek sot këtu.

Shkenca është konsideruar historikisht në mbarë botën si domen i meshkujve. Megjithatë femrat e kanë dhënë kontributin e tyre të padiskutueshëm për shkencën, por për rolin e

tyre në këtë drejtim është folur pak dhe për aq më tepër shumë shpesh meritën për punën e tyre e kanë grabitur meshkujt.

Storiet e femrave të suksesshme në shkencë tregojnë për pengesat e mëdha në të cilat kanë hasur ato gjatë rrugëtimit të tyre deri te zbulimet historike shkencore dhe këto pengesa iu janë shfaqur thjeshtë pse ishin femra. Një numri të madh të tyre mezi iu është lejuar të arsimoheshin. Disave iu është lejuar të punojnë vetëm nëse punojnë pa pagesë. Disave, në vend të laboratorit, iu është lejuar të punojnë vetëm në bodrume.

Por, edhe për kundër sfidave të panumërta, shumë gra kanë shkëlqyer në shkencë. Femrat shkencëtare shpeshherë kanë kaluar ditë e natë të gjata pune në laboratore për të përfunduar me zbulim epokal glorifikimin për të cilin do ta merrnin kolegët e tyre meshkujt.

Shembulli i tillë është Rosalind Franklin, puna e së cilës ishte kyçe në zbulimin e strukturës molekulare të ADN-ës. Të dhënat e saj, pa dijen e saj, iu prezantuan Uadson-it dhe Kirk-ut të cilëve u ndihmuan për të plotësuar pjesët e pazgjidhura të mozaikut. Ata arritën të publikonin para saj dhe më vonë të shpërbleheshin me çmimin Nobel.

Shembull tjetër, është Lise Meitner, e cila është kontribuuesja kryesore për zbulimin e fisionit bërthamor që më vonë dërgoi deri te zbulimi i bombës atomike. Megjithatë, meritat bashkë me çmimin Nobel shkuan te bashkëpunëtori i saj Otto Hahn. Shembuj të tillë ka edhe shumë të tjerë.

Megjithatë, deri më sot 16 herë gratë janë shpërblyer me çmimin Nobel për fizikë, kimi, fiziologji apo mjekësi. Marija Kiri, duke qenë e para dhe e vetmja femër e cila e mori dy herë këtë shpërblim.

Barrierat për gruan në shkencë janë prezent edhe sot në mbarë botën. Ndërkaq, te ne edhe më shumë. Në një ambient shumë të vobektë të shkencës në Kosovë dhe në trojet shqiptare në përgjithësi, edhe përfaqësimi i gruas në shkencë është mjaft i zbehtë.

Sot, në krahasim me një të kaluar relativisht të afërme, mund t'i gëzohemi arsimimit dhe emancipimit të gruas në shoqërinë tonë. Por, përkundër kësaj, numri i profesorëve universitar të gjinisë femërore, në raport me atë të gjinisë mashkullore, është në nivel të pa krahasueshëm.

Në anën tjetër, Statuti i UP-ës është inkurajues në këtë drejtim, meqë parasheh se për zgjedhjen e kuadrit akademik në kushtet të barabarta kanë përparësi femrat. Kurse, në praktikë një gjë e tillë nuk vihet re. Madje, edhe në kushte shumë më të disfavorshme, gjasat shumëfish më të mëdha janë për kandidatët meshkuj, duke pasur parasysh mundësinë më të madhe të tyre për lidhje miqësore, partiake e tjera, që sot janë determinuesit kryesorë për avancimin akademik.

Ndërkaq, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si institucioni më i lartë i shkencës në vend, nuk është asnjë anëtare e rregullt femër. Puna shkencore për nga natyra

e saj, është punë e rëndë, që do shumë përkushtim, dhunti por edhe investim të madh në dije dhe në kohë.

Gruaja, duke qenë në të shumtën e rasteve edhe nënë dhe duke pasur parasysh rolin e saj të pakontestueshëm në ngritjen e familjes, medoemos që i duhet energji e madhe për të shkëlqyer në sferën e shkencës.

Andaj, konsideroj se për ato gra që kanë ambicie shkencën, ne si shoqëri duhet të gjejmë mekanizma që t'ua bëjmë rrugën më të lehtë. Si hap konkret në këtë drejtim, propozoj që t'i jepet përparësi bartëse edhe femrave të projekteve shkencore apo të caktohet kuota gjatë ndarjes së fondeve për projekte shkencore. Formë tjetër do të ishte inkurajimi i vajzave që nga shkollimi i ulët, sidomos i atyre me prirje për lëndë të caktuara, nëpërmes fushatave senzibilizuese që do t'i luftonin stereotipet për profesione të caktuara. Pra, të përpiqemi si shoqëri që të ndërtojmë një ambient të mirë për gruan në shkencë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala!

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje ministre Çitaku,

Përshëndetje kolegë deputetë dhe deputete dhe ju të pranishëm,

Pika e rendit të ditës pra është debat parlamentar për Ditën ndërkombëtare të gruas, ndërsa unë do të përpiqem të jem shumë e shkurtër.

Fjalën e mora për ta mbështetur këtë debat dhe punët tona janë çdo ditë, jo vetëm në ditët kur zhvillohen debat në lidhje me avancimin e gruas dhe të shoqërisë në përgjithësi. Mbi të gjitha fjalën e mora që t'i përshëndes të gjitha gratë e Kosovës me rastin e festave të marsit. Marsi për ne është muaj i veçantë dhe festat në këtë muaj janë të shumta dhe domethënëse, siç janë festa datat 5, 6 e 7 mars që e mbanë një emër shumë të rëndësishëm si Epopeja e UÇK-ës, 8 marsi si Dita ndërkombëtare e gruas dhe 11 marsi si dita që ka shënuar kthesën e madhe në Kosovë dhe është shumë e rëndësishme për popullin e Kosovës dhe popullin shqiptar në përgjithësi.

Mbi të gjitha, do t'i jap vetes pak të drejtë që në këtë ditë t'iu bëj një ftesë publike të gjitha grave të brezit 81, që të marrin pjesë në akademinë e organizuar nga kryeministri i Kosovës, zoti Thaçi me rastin e 31 vjetorit të demonstratave të vitit 1981. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj!

RITA HAJZERAJ - BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

E nderuar nënkryetare,

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë,

Të drejtat e njeriut përshkruajnë një koncept sipas të cilit të gjithë njerëzve iu takojnë që nga lindja. Janë të drejtat që garantohen me të gjitha aktet më të larta juridike, kombëtare dhe ndërkombëtare. Mirëpo, që të jetë sa më efektiv respektimi i lirive të të drejtave të

njeriut, është e domosdoshme që respektimi i tyre të bëhet pa dallime qoftë në aspektin gjinor apo në aspekte të tjera.

Të drejtat e grave janë të drejtat e njeriut, të drejta që gratë i gëzojnë për faktin e thjeshtë sepse janë qenie njerëzore. Athua nuk janë njësoj të vlefshme ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare, e po ashtu edhe konventat tradicionale të drejtave të njeriut për burrat e për gratë?

Në Ditën ndërkombëtare të gruas 8 marsi, kosovarët mendojnë se ka paragjykime të shumta për të drejtat e tyre dhe ato vazhdojnë të jenë të censuruara si në shoqëri ashtu edhe në familje. Femrave nuk iu ofrohet hapësira e duhur për të treguar aftësinë dhe diturinë që e kanë, nga se të drejtat ja në vetëm letra dhe si të tilla nuk zbatohen.

Të drejtat e grave në Kosovë, edhe më tutje vazhdojnë të jenë vetëm letra dhe se ato nuk po jetësohen dhe se jetësimi i tyre vazhdon të mbetet shumë i mangët.

Edhe përkundër hartimit të akteve juridike që e rregullojnë çështjen e barazisë gjinore në Kosovë, prapëseprapë kjo çështje është e mangët dhe se duhet të bëhet shumë më shumë përpjekje për të krijuar mundësinë e respektimit të të drejtave të grave në Kosovë, sepse nuk mjafton vetëm krijimi i normave por duhet të krijohen edhe kushtet për zbatimin efektiv të tyre.

Dhuna ndaj gruas nuk njeh kufi. Anëmbanë botës ato shfrytëzohen në mënyra të ndryshme. Në Kosovë ka mjaft raste të dhunës ndaj femrave dhe kjo dukuri është mjaft shqetësuese. Për këtë arsye duhet të merren masa urgjente që të evitohen rastet e tilla dhe të krijohen kushtet me anë të cilave iu mundësohet femrave që të kenë qasje të barabartë me mashkullin në jetën shoqërore sepse dihet qartë që kontributi i femrës në shoqëri është i pazëvendësueshëm dhe se nuk mund të paramendohet një shoqëri e zhvilluar në qoftë se femra nuk është e barabartë me mashkullin.

Kjo gjë është e mundshme vetëm nëse punohet seriozisht në këtë drejtim, duke krijuar norma juridike, mirëpo nuk mund të themi se janë bërë hapa në këtë drejtim nëse normat e krijuara nuk mund apo kanë ngecur së zbatuari, por duhet të bëhet përpjekje për krijimin e normave adekuate juridike që do të jenë në pajtim të plotë me standardet ndërkombëtare dhe të krijohen mekanizma që do të merren për zbatimin e normave që i mbrojnë femrat nga diskriminimi dhe pa barazia në shoqëri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gëzim Kelmendi!

GËZIM KELMENDI: I nderuari kryetar,

E nderuara ministre,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Në bazë të praktikave të deritashme parlamentare, sa herë që kemi pasur debate parlamentare, kryesisht unë por edhe të tjerët kemi folur ulur nga vendi ku jemi. Por, për faktin se sot kemi një debat parlamentar që ka të bëjë me të drejtat e gruas në Kosovë dhe

respektin që e kam për gjininë femërore vendosa të dal këtu para jush dhe të ju përshëndes dhe shpreh përkrahjen dhe mbështetjen e plotë për juve.

Njëherit, Grupin e grave deputete e përgëzoj për këtë organizim të këtij debati, por nuk pajtohem me një çështje që ky debat të jetë vetëm me një ditë të caktuar, ashtu siç është bërë për nderë të 8 marsit, por ky debat të jetë më i fuqishëm, më i mbështetur dhe të jetë më i organizuar dhe më i shpeshtë për faktin se gruaja nuk meriton të nderohet vetëm 1 ditë brenda 365 ditëve, por duhet të nderohet vazhdimisht çdo ditë, më fuqishëm dhe në mënyrë më dinjitoze.

Prej se ekziston njerëzimi në këtë planet, gruaja e ka pasur rolin kryesor në zhvillimin, edukimin, përparimin dhe civilizimin e shoqërisë dhe të njerëzimit në përgjithësi. Në luftë dhe në paqe gruaja ka qenë faktor dominant në zhvillimin dhe civilizimin i cili nuk mund askush ta kundërshtojë.

Edhe te ne në Kosovë, nëpër të gjitha periudhat e ndryshme historike, gruaja ka luajtur rolin e vet dhe ka ushtruar ndikimin e saj sa që është për tu marrë lakmi nga të gjitha gratë e vendeve të tjera që e lakmojnë këto rol që e kanë ushtruar.

Unë nuk dua t'i përmend këtu emrat e grave nëpër histori të Kosovës që kanë kontribuar, por dua të përmendi atë që ndoshta nuk më ra rasti të dëgjoj dhe me të cilën mburrem – me nënën Zahide Jashari e cila i lindi, rriti dhe luftoi bashkë me djemtë e tyre Adem Jasharin dhe Hamzën, për çka edhe kolegët tjerë e paskan përmend.

Po sot pyesim se çka po bën shoqëria jonë kosovare për gruan në përgjithësi. Unë them me përgjegjësi të plotë se gruaja nuk është duke u trajtuar me meritën dhe respektin të cilin vërtetë ajo e meriton. Them jo, nga se në shoqërinë tonë gruaja nuk vlerësohet si personalitet me vlera të larta intelektuale por vlerësohet dukja dhe ekstravaganca e saj. Thënë shkurt, vlerësohet më shumë për bukurinë që e ka se sa për vlerat e mirëfillta që i gëzon.

Jemi dëshmitarë për shumë keqpërdorime, abuzime, shantazhe dhe kërcënime që i bëhen gruas kosovare. Duhet ta pranojmë dhe një fakt dhe një aktualitet prezent te ne në Kosovë, çka nuk ka qenë i njohur deri më tani, se vërtet Kosova është e zhytur në një krizë të thellë morale. Dhe kjo për faktin se mungon respekti dhe vlerësimi i duhur përballë gruas në Kosovë dhe ajo sot shihet me sy si objekt tërheqës e i keqpërdorimit dhe jo që kontribuon për shoqërinë tonë. Kjo krizë e ka një zgjidhje e për këtë përgjegjësia kryesore bie mbi prindërit dhe mbi institucionet arsimore dhe në krye me Ministrinë e Arsimit.

Fëmija në familje dhe në shkollë duhet të edukohet ashtu siç zoti i madhëruar kërkon që nëna të respektohet më shumë se babai, që gruaja të respektohet nga bashkëshorti. Kur është në raport me shoqëri të ketë kolegja përparësi ndaj kolegëve meshkuj dhe kur është pyetja te fëmijët vajza të respektohet, të duhet e çmohet dhe të jetë prindi më i kujdesshëm ndaj vajzave se sa ndaj djemve.

Zgjidhjen e këtij problemi në gjitha vendet e Bashkimit Evropian me dekada e kanë nisur përmes një rruge të cilën ne vetëm e injoruar para disa muajve këtu në Parlamentin e Kosovës përmes edukatës fetare në shkollat publike e private.

Faktor tjetër që e bën gjendjen më të rëndë të gruas në shoqërinë tonë është edhe dhuna e tepërt që ushtrohet ndaj gruas, qoftë në viset rurale, qoftë në viset urbane. Kjo torturë dhe dhunë që ushtrohet ndaj gruas pa dyshim e ka një adresë, e ka një bazë negative dhe ajo është për shkak të dominimit të sistemit patriarkal që ende ekziston në disa familje kosovare dhe mendësisë apo prezencës së kanunit të Lekë Dukagjinit i cili në nenin 20 dhe 28 thotë se “gruaja është tepërcë në familje, nuk ka të drejtë në trashëgimi dhe burri nëse e rrah gruan deri në alivanosje, nuk ka përgjegjësi ndaj gruas”.

Ju e dini mirë se të gjitha këto duhet të ndryshohen dhe duhet një punë për të ndërruar vetëdija e tillë e qytetarëve të Kosovës. Prandaj, neve na duhet punë për gruan e cila ka qenë dhe është shtyllë e familjes dhe e shtetit në përgjithësi.

Unë e përgëzoj Grupin e grave deputete për një nismë të tillë dhe iniciativë të tillë dhe kërkoj që këto debate të jenë më të sheshta dhe të fuqishme. Njëherit kërkoj nga Grupi i grave deputete për mirëkuptim, të kenë mirëkuptim edhe për gjininë e tyre, konkretisht për vajzat e reja të cilat po privohen nga shkollimi i tyre fillor e i mesëm, që është obligativ dhe të cilat padrejtësisht po largohen nga shkolla për shkak të mbulesës dhe shamisë. Ne e dimë fort mirë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji aktual i arsimit para-universitar e definojnë qartë dhe lejon manifestimin publik për bindje fetare, por është një udhëzim administrativ i nxjerrë në vitin 2010 i cili po i largon këto vajza nga shkolla në mënyrë të padrejtë e aq më të rëndë po e bën faktin me atë se ky shkollim është obligativ.

Fundi i fundit, edhe Kosova është përcaktuar për një rrugë dhe ajo është rruga për në Bashkimin Evropian dhe këto vajza nuk po kërkojnë më shumë asgjë se sa koleget e tyre në Bashkimin Evropian, të jenë të lira, të shkollohen pavarësisht bindjeve të tyre fetare. Asnjë vend dhe asnjë rajon i Bashkimit Evropian nuk e ndalon shkollimin e vajzave për shkak të mbulesës, ndërsa ne, një gjë të tillë po e bëjmë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli!

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Tema që po e diskutojmë sot, padyshim se është i një rëndësie të madhe shoqërore, politike dhe kulturore. Pra, analizimi i pozicionit të femrës në shoqëri, i statusit, të drejtave dhe lirive që ajo i gëzon, mbasin disa nga kriteret thelbësore për vetë definimin e asaj shoqërie. Dhe ashtu siç është e ditur prej kohësh, jemi mësuar që shoqëritë njerëzore historikisht, krahas shumë stratifikimeve të brendshme sociale, politike dhe ekonomike, po ashtu t'i ndajmë edhe në dy kategori themelore: pra në shoqëritë e përbëra nga burrat dhe gratë. Dhe është e ditur se ky proces, qoftë në nivel të përgjithshëm ashtu edhe brenda kontekstit tonë shoqëror, ka qenë i pleksur me shumë paragjykime, mite dhe narracione përjashtuese që e kanë definuar edhe statusin e gruas në shoqëri. Kështu, edhe analizimi i kësaj teme sociale që mbulon sferën e relacioneve gjinore, mbetet një sfidë e

vërtetë mendore, sepse fillimisht kjo nënkupton një vështrim gjenealogjik të shtresëzimeve diskursive që kanë ndikuar në etablimin e këtyre relacioneve. Ndërkaq, ajo që spikatë si thelbësore në këtë proces, mbetet pa dyshim ndërlidhja imanente ndërmjet ligjëritit dhe pushtetit. Në këtë sens, edhe mendimet thelbësore që janë sajuar për gratë kanë qenë të projektuara nga ata që e kanë pasur pushtetin real konkret mbi vetë ato, ashtu siç kanë vë në dukje me të drejtë në pah shumë epistomologë feministë – çdo dije është kontekstuale dhe pasqyron pozicionin e përfituesit të dijes në një moment historik të caktuar dhe në një kontekst të dhënë materialo-kulturor.

Prandaj, po të shprehemi me një vështrim sipërfaqësor, drama e vërtetë e problemeve të gruas ka qenë e derivuar nga fakti se asaj në histori i është imponuar heshtja, pra shumica e vështrimeve teorike dhe në mënyrë eksplicite e kanë përkufizuar atë si një subjekt të heshtur dhe të fshehur, kurse si përcaktim qenësor i gruas ka qenë më shumë roli i saj si të qenit për tjetrin se sa si të qenit për veten.

Rrjedhimisht, kjo ndarje duale ontologjike ka bërë që më shumë edhe vetë gruaja të ketë perceptuar qenien e saj si diçka e cila duhet ta zgjidhë veten jo ashtu siç ajo ka qenë në të vërtetë por ashtu siç e kanë përcaktuar të tjerët. Esencialisht, ajo është prangosur brenda një esence të pandryshueshme dhe të përrjetshme si e përjashtuar nga e drejta e fjalës për qenien e saj, kurse krejt çka ka mundur të reflektohet mbi gjendjen e saj kanë qenë mendimet që burrat kanë sajuar për gratë më shumë se sa vetë ato për veten e tyre.

Dhe, konsekuencat mendore të kësaj trashëgimie patriarkale, mund të thuhet se i hasim deri në ditët e sotme. Madje, siç kemi pasur rastin që këtë vit në Parlamentin e Kosovës të shpërndaheshin fletore pune të mbushura me aso sentenca maskoliniste që e promovonin heshtjen e gruas si virtyt qenësor të saj.

Mirëpo, përtej këtyre vështrimeve historike, shumica e të cilave dikur e kishin gëzuar statusin e dijes absolute, por që praktika i ka përgënjeshtuar vetëm si paragjykime të kohës, fokusi i debatit konsideroj se tashmë duhet të orientohet në një rrafsh tjetër. Pra, është e vërtetë se shumë gjëra kanë lëvizur pozitivisht. Janë njohur dhe pranuar të drejtat abstrakte dhe liritë formale që garantojnë trajtimin e barabartë juridik të gruas. Përsëri, gjendja në rrafshin sociologjik, mbetet larg idealit të synuar.

Është e ditur se pikësëpari vetë e drejta abstrakte nuk mjafton për të përcaktuar gjendjen konkrete të gruas. Në pjesën më të madhe ajo varet nga roli ekonomik që luan, madje shpesh liria abstrakte dhe pushtetet konkrete ndryshojnë në kah të kundërt.

Dhe pyetja esenciale që sot shtrohet për diskutim, ka të bëjë me çështjen se: cilat janë këto rrethana konkrete që sot e kufizojnë lirinë e gruas dhe si mund t'i kapërcejmë ato? Kështu, po të analizohet kjo gjendje konkrete, ende sot, me gjithë shpalljen e lirive formale, gjendja e gruas vazhdon të jetë tejet e pa barabartë në shumë sfera vitale të shoqërisë sonë. Ajo ende nuk është trashëgimtare reale e pronës, e kufizuar në mundësi ekonomike dhe e ballafaquar me shumë sfida dhe vështirësi sa i përket mundësive akademike.

Vetëm nëse analizojmë strukturën drejtuese të institucioneve shkencore publike, ne do të zbulojmë thelbin e pabarabartë të përfaqësimit të gruas në këto institucione. Bie fjala, sot e kësaj dite në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës të gjitha pozitat udhëheqëse iu takojnë burrave. E njëjta situatë vlen edhe në Rektorat, në Senat, në Dekanatin e këshillave të fakulteteve, ku përfaqësimi adekuat gjinor thuaja se mbetet marginal dhe jo adekuat. Po ashtu, që nga largimi i presidentes aktuale nga Shërbimi Policor i Kosovës, as në këtë institucion sot, mund të thuhet, nuk ka asnjë grua në pozicionet e rëndësishme drejtuese dhe është e ditur se ky është institucion i rëndësishëm që garanton sigurinë e përgjithshme. Përgjithësisht, ky diskriminim në masë të madhe sot është një hendikep i madh për shoqërinë tonë, sepse në instancë të fundit, ai përjashton gjysmën e saj nga mundësitë produktive. Rrjedhimisht ai kufizon edhe burrat, sepse i shndërron ata ende në pengje të paragjytimeve dhe limiton mundësitë e tyre për njohje reale dhe përmbajtësore të vetë të qenit tonë njerëzor. Është e ditur se nga relacioni i barabartë i burrit me gruan, që mund ta ndërtojmë në të gjitha dimensionet e mundshme, do të krijohen premisa të duhura për realizimin e njeriut si qenie totale në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi diskutues të tjerë!

(Ndërhyrje)

Jo, e keni pasur fjalën! Ju lutem, nuk ka nevojë përgjigje për askë. Fjala është kryer.

Një gjë dua ta them pasi po i referohet të kaluarës dhe iu referua kanunit të Lekë Dukagjinit.

Unë jam i obliguar të them që kanuni i Lekë Dukagjinit në kohën kur ka ekzistuar ka qenë më i përparuari se shumë kanune tjera dhe ligje tjera që janë përdorur në këtë botën tonë. Prandaj, ta kemi parasysh këtë.

Edhe një herë po e them, ka qenë më i përparuari dhe sidomos për këto troje nuk ka pasur ligj dhe kanun apo kushtetutë më e përparuar.

Prandaj, mos t'i referohemi historisë. Ne këtu jemi të obliguar t'i referohemi të sotmes dhe të ardhmes. Deri sa të na vijnë rekomandimet, e bëjmë një pauzë prej 15 deri 20 minuta.

(Vijon pauza)

(Pas pauze, seanca vazhdoi punën)

KRYETARI: Pasi e kemi mbyllur debatin, fjalën ia kisha dhënë deputetes Teuta Sahatqija për të prezantuar rekomandimet.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, i nderuari kryetar!

I nderuar nënkryetar,
E nderuar ministre,
Që ka mbetur prej kabinetit qeveritar, sepse ka interesim.

Ne u takuam. I analizuam rekomandimet dhe prej një numri të madh të rekomandimeve arritëm që t'i zvogëlojmë, në fakt që t'i koncentrojmë shumë rekomandime në disa pika. Tash do t'i lexoj rekomandimet me të cilat u dakordua me të gjitha grupet parlamentare.

1. Të trajtohen me ligj rastet e grave të dhunuara gjatë luftës. Gjithashtu i bëjmë thirrje drejtësisë vendore e ndërkombëtare të dënojnë kryerësit e këtyre krimeve që paraqesin elemente të krimit të gjenocidit;
2. Të hartohen politikat që fuqizojnë ekonomikisht gratë dhe favorizojnë iniciativat e grave në biznes. Ministria e Integrimit Evropian të ndërmerr veprime konkrete për të përfituar fondet strukturale të BE-së të cilat do të shfrytëzoheshin për gratë në ndërmarrësi, afarizëm, bujqësi, artizanate dhe shkencë;
3. Në universitete të zhvillohen kurrikulat në favor të politikave gjinore në veçanti politikave që përgatisin gratë për veprimtari ekonomike. Po kështu, të rishikohen tekstet mësimore në të gjitha nivelet dhe të pastrohen nga të gjitha stereotipat negative për gratë;
4. Të zbatohen në tërësi dispozitat kushtetuese, ligjore dhe atyre nga konventat ndërkombëtare për përfaqësimin e barabartë të grave në diplomaci;
5. Të respektohet Ligji për barazi gjinore në bordet e ndërmarrjeve publike;
6. Të zbatohet në tërësi strategjia kundër dhunës në familje dhe të ndëshkohen me dënime serioze ushtruesit e dhunës;
7. Të zbatohet në tërësi Ligji i punës. Në veçanti të ndërmerren veprime konkrete nga Inspektorati i punës; dhe
8. Të zbatohen në tërësi dispozitat kushtetuese, ligjore dhe ato që dalin nga obligimet ndërkombëtare për trajtimin e barabartë të gruas në shoqëri.

Kryetar, këto ishin rekomandimet për të cilat u dakordua me të gjitha grupet parlamentare.

KRYETARI: Faleminderit!

Ne debatin e kemi kryer. Unë mendoj se në pikën 1, duhet të bëhet ndoshta një riformulim pak. Pra, të jetë:

“Të trajtohen me kujdes të veçantë gratë e dhunuara gjatë luftës”. Pra, kjo le të jetë “me kujdes të veçantë”.

(Ndërhyrje)

Pra: “Të trajtohen me kujdes të veçantë”.

(Ndërhyrje)

Shikoni! Ne mund të themi si të doni, por unë mendoj se kështu duhet të jetë, sepse e keni më poshtë respektimin e Ligjit, respektimin e Kushtetutës dhe respektimin e të gjitha tjerave dhe unë konsideroj se nën 1 duhet të jetë: “Të trajtohen me kujdes të veçantë”, sepse ligjet mund të implikojnë diçka që ne s’mund të miratojmë.

Unë mendoj se kjo do të ishte si duhet: “të trajtohen me kujdes të veçantë gratë e dhunuara gjatë luftës”, pa e ndryshuar asnjë pjesë tjetër.

(Ndërhyrje dhe ndërprerje e shkurtër)

Ne mund të themi si të doni, por se a ka dhe a mund ta gjejmë ndonjë mostër kund? Janë disa çështje që kur janë ligjet, ligjet janë një kategori e veçantë dhe duhet këtë ta kemi parasysh. Urdhëro! Fjalën e ka Kimete Bajrami, pastaj Flora Brovina!

KIMETE BAJRAMI: I nderuar kryetar!

Unë sot nuk fola për pozitën e femrës në përgjithësi, se folën mjaft deputetët dhe deputetët këtu, të cilët i falënderoj shumë.

Mirëpo, kur bëhet fjalë për femrat e dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë, besoj se është çështje më e ndjeshme gjinore. Dhe duhet me të vërtetë të kemi kujdes të veçantë. Por, kujdesin e veçantë nuk mund ta matim as ta përcaktojmë me kurrëgjë.

Po kërkohet ndihmë institucionale për këto viktime të luftës së fundit. Pra, ndihmë institucionale dhe këtë mund ta bëjmë vetëm përmes ligjit. Na e nxjerrim një ligj, nuk kemi nevojë që ta kemi ndonjë kopje të vendeve të rajonit ose diku tjetër, por marrim iniciativë, e nxjerrim një ligj dhe këto duhet të jenë përfituese nga institucionet. Sepse, janë pjesë, është segmenti i popullsisë më i atakuar. Janë në gjendje më të vështirë dhe shumë më të vështirë se sa ata që kanë pësuar me vdekje. Nuk i trajton askush. Janë komplet të marginalizuara nga kjo shoqëri. Edhe unë besoj se duhet të trajtohen me ligj në mënyrën dhe aspektin që ato të jenë përfituese, qoftë në ndihmë materiale ose diçka tjetër, mirëpo ato duhet të jenë të diskriminuara pozitivisht nga ana e kësaj shoqërie. Ju faleminderit!

KRYETARI: Flora Brovina e ka fjalën dhe nuk ka diskutim më.

FLORA BROVINA: Ndoshta jam e thirrur të flas për pikën një, sidomos për shkak se shumë nga këto gra nuk ka besuar në historitë e tyre dhe jam një dëshmitare e dhunës së tmerrshme që quhet gjenocid ndaj popullit tonë dhe krim i rëndë i luftës – dhuna ndaj gruas. Natyrisht se jam përpjekur gjatë tërë kohës si deputete që të gjejë format dhe të

dalim së bashku në mbrojtje të këtyre grave. Dikush e përmendi rastin e grave të Bosnjës. Më falni, por ato edhe rishtaz u dhunuan në Gjykatën e Hagës. Unë nuk pajtohem që gjykimi i krimit është krejt ajo çka duhet të bëhet.

Kujtoj se këtyre grave, së pari iu është nevojitur ky debat që të flasim lirshëm dhe ta thejmë tabu-temën për dhunimin e grave në Kosovë. Dhe, kjo do të thotë mbështetje morale e tyre. Kjo është pra çështja kryesore.

Në Parlamentin e Kosovës, natyrisht, është folur edhe herëve tjera, sidomos kur është nxjerrë Ligji për viktimat civile të luftës dhe këto gra mund të hyjnë apo marrin pjesë në veteranët e luftës, nëse kanë qenë të tilla, natyrisht dhe mund ta gjejë pra vetveten dhe përkrahjen. Kjo është theksuar seriozisht se ato hyjnë në kategori civile të luftës.

Unë kujtoj se nuk ekziston, e ndoshta jam e mashtruar, një ligj i veçantë që ato të shpërblehen, sepse tani pas kaq kohe është vështirë të sigurohet vërtetimi se ato vërtet janë të dhunuara. Mirëpo, ne e dimë historinë e tyre. Ka edhe forma tjera të përkrahjes dhe përshtatjes së tyre, ngritja e akuzës ndoshta për krime të luftës dhe gjenocid dhe ndonjë përkrahje tjetër që tua lehtësojmë jetën. Pra, ta thejmë edhe tabu – temën rreth dhunimeve të grave.

Unë kujtoj se një ligj çfarë është propozuar këtu, si ligj i veçantë, është shumë vështirë të nxirret, sepse ne nuk kemi mundësi. Nuk kemi mundësi as të dëshmojmë dhe është shumë e papërshtatshme sepse ndoshta mbetet vetëm në letër më tutje. Ndërsa, në kuadër të Ligjit për viktimat civile ato mund ta gjejnë vetveten, dhe ky ligj është në funksion.

KRYETARI: Faleminderit! Jo, nuk do të diskutojmë më! Dëgjoni edhe këtë, ose e lëmë bisedojmë nëpër grupe parlamentare, sepse nuk mund t'i votojmë kështu siç janë.

Ne kemi përgjegjësi, dhe këtë duhet ta dimë. Do të thotë, “kërkojnë trajtim të veçantë institucional gratë e dhunuara gjatë luftës” dhe me të tjerat pajtohemi të mbeten ashtu.

A jeni dakord për këtë ndryshim?

Atëherë lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Votojmë me korrigjimin që e lexova unë, këtë të fundit.

Me 54 vota për, 1 kundër, asnjë abstenim – miratohen Rekomandimet me ndryshimin e cekur së fundi.

Në sallë ishin 61 deputetë.

Me kaq, po e kryejmë punën! Mirë u pafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia për transkriptim dhe lekturë